

Pjesa më e madhe e të gjitha krijimeve me temë shqiptare ndodhet jashtë Shqipërisë. Më të mirat prej tyre janë të ekspozuara nëpër muze dhe galeri të njohura të artit botëror. Disa tablo bëjnë pjesë në fondet e posaçme të këtyre institucioneve për ekspozime të përkohshme, ndërsa punime të tjera (që përbëjnë numrin më të madh, kryesisht skica, etyde dhe bocete) ruhen në departamente të veçanta si objekte studimi për historinë e zhvillimit të artit apo historikun e krijimtarisë së autorëve që i kanë realizuar.

FONDI SHQIPTAR I AUTORËVE TË HUAJ

nga Ferid Hudhri

DY LIBRARI TË REJA, TË MËDHA, HAPEN KËTË FUNDJAVË

Në Prishtinë: Libraria "Alterra", adresa Magjistralia Prishtinë Fushë Kosovë, pranë Universitetit AAB

Në Tiranë: Showroom & Librari "Aladini", Bllok, përballë BKT, Tiranë

SHËNIME MBI LIBRAT

Botohet në maqedonisht romani "Dashuria e nëmur në Maligrad" i shkrimtarit Luan Rama

Dëshmia romaneske për një dashuri shekspiriane

Nga Luan Starova

(fq. 20)

Shënime për librin "Letër Dylqinjës" të Agim Baçit

Alkimia e takimit të tekstit me lexuesin

Nga Namir Lapardhaja

(fq. 9)

Një vëllim i ri, një personazh i ri dhe një autor i ri

Recension mbi prozën "Andrush", të autorit më të ri të letërsisë për fëmijë Flori Kasaj

nga Prof. Dr. Klara Kodra

(fq. 13)

Botohet në Spanjë libri E BUKURA E DHEUT, me 106 përralla shqiptare, të përzgjedhura nga studiuesja dhe përkthyesja MARÍA ROCES GONZÁLEZ

GJERDAN PERLASH TË KULTURËS SHQIPTARE

Nga Namik Dokle

(fq. 6)



Takimet e mia me poetin e famshëm italian, MARIO LUZI

Nga Artur Spanjoli

E njoha poetin hermetik nga Firenze Mario Luzi-n vite më parë në të njëjtin qytet ku edhe banoj që prej 30-tëvjesh. Kur erdha në Itali në Nëntor të 92-shit, isha një i ri 22 vjeçar, i cili nuk kishte ikur nga vendi i tij thjeshtë veç për arsye ekonomike. Mbi të gjitha, shtysa më e madhe kishte qenë etja ime për dije. Dëshira e zjarrtë për të nxënë.

(fq. 16)

NJË LETËR E PAZAKONTË E MID'HAT FRASHËRIT

Nga Uran Butka

(fq. 11)



PRANVERA e Sandro Botticelli

Dr. Bledar Kurti

(fq. 22)

BIBLIOTEKË

— Andon Andoni

(fq. 10)

Në prag të kërsëndellave

— Enver Kushi

(fq. 12)

Shtatë ditë (me të dielën)

— Odiseas Elitis

(fq. 14)

Poezi (Përktheu Niko Kacalidha)

Rreth librit të prof. Anton Nikë Berishës, *Martin Camaj:*
"Letërsia ashtë jeta ime e vërtetë"

**Letra që shpalosin në thellësi
botën dhe veprimtarinë letrare
dhe gjuhësore të Martin Camajt**

Nga Skënder Asani

(fq. 8)

**A ekziston ndonjë lidhje e
qenësishme mes mërzi
dhe të bërit art?**

*Nga Beethoveni te Leonard
Cohen, Susan Cain përsiat rreth
melankolisë dhe kreativitetit*

(fq. 21)

Pjesa më e madhe e të gjitha krijimeve me temë shqiptare ndodhet jashtë Shqipërisë. Më të mirat prej tyre janë të ekspozuara nëpër muze dhe galeri të njohura të artit botëror. Disa tablo bëjnë pjesë në fondet e posaçme të këtyre institucioneve për ekspozime të përkohshme, ndërsa punime të tjera (që përbëjnë numrin më të madh, kryesisht skica, etyde dhe bocete) ruhen në departamente të veçanta si objekte studimi për historinë e zhvillimit të artit apo historikun e krijimtarisë së autorëve që i kanë realizuar. Edhe nëpër koleksione të ndryshme publike, private apo familjare, kryesisht në ato të pasardhësve të artistëve që kanë udhëtuar për të pikturuar, gjenden gjithashtu krijime po aq të bukura e të çmuara.

Thuajse të gjitha vizatimet, akuarelet apo etydet që piktorët e huaj i realizuan nëpër trojet shqiptare i morën në studiot e tyre, për t'i përpunuar artistikisht dhe për t'i paraqitur më pas në sallonet e artit nëpër Europë. Ajo pjesë e vogël e veprave, që sot përbën fondin shqiptar është krijuar nga disa prej punimeve që u realizuan dhe u ekspozuan në vendin tonë.

Nga 30 prilli i vitit 1918, kur në Shkodër u çel e para ekspozitë e autorëve të huaj (prej artistëve austro-hungarezë Horovitz, Pravotinski dhe Beszedes), më pas në Korçë (nga piktorët francezë Jean Bigou më 1932 dhe Jaques Bernoles më 1936), e deri në dhjetor të vitit 1943, kur në Tiranë u mbyll ekspozita e piktorit italian Umberto Marchetti, para vizitorëve shqiptarë u paraqitën rreth 500 vepra arti. Krahas autorëve të mësipërm, midis viteve 1918-1943 nëpër sallonet shqiptare ekspozuan krijimet e tyre edhe artistë të tjerë nga Italia, Gjermania, Polonia, Serbia dhe Bullgaria. Gjithsej u organizuan 13 ekspozita vetjake dhe një kolektive. Përmes veprave të artit shqiptarët panë veten e tyre sipas shëmbëlltyrës së krijuar nga artistë të vendeve të tjera. Por pas mbylljes së ekspozitave edhe veprat e artit u larguan bashkë me autorët. Një pjesë fare e vogël prej atyre

FONDI SHQIPTAR

i

AUTORËVE TË HUAJ

nga Ferid Hudhri

Alfredo Biagini, *Fragment nga relievet e vitit 1941*, Banka e Shqipërisë, Tiranë

pikturave mbeti në Shqipëri, kryesisht nëpër koleksione private, familjare. Një numër i papërfillshëm syresh edhe në institucione publike apo shtetërore. Nga mungesa e galerive apo muzeve të artit në atë kohë kishte më shumë vështirësi për ekspozimin si dhe ruajtjen e veprave të krijuara nga autorët e huaj apo vendas.

Artistët që erdhën për të pikturuar pas vitit 1945 u përkisnin vendeve të Bllokut të Lindjes. Zakonisht vinin nga dy, tre apo më shumë piktorë bashkë. Në shtator të vitit 1955, 19 artistë nga Polonia (grupi më i madh i krijuesve të huaj që ka ardhur deri tani në Shqipëri), pasi pikturuan nëpër disa krahina të vendit, paraqitën në Tiranë

mbi 100 peizazhe, portrete, tablo, etyde, vizatime me laps dhe tush. Në diskutimin krijues të zhvilluar midis artistëve nga të dyja vendet, skulptori Odhise Paskali shprehu mendimin që “disa prej atyre punimeve të bliheshin nga shteti dhe të vendoseshin në Galerinë e Arteve”¹. I njëjti mendim u shpreh edhe për ekspozitat që u hapën më pas. Nga viti 1955 deri më 1965 në Tiranë u organizuan 10 ekspozita me krijime të autorëve nga Polonia, ish-Bashkimi Sovjetik, Çekosllovakia, ish-Gjermania Lindore, Kina, Japonia, Belgjika dhe Koreja. Gjatë kësaj periudhe mund të jenë paraqitur mbi 800 vepra nga 50 autorë të ndryshëm. Vetëm piktorët Evgeni Zaicev, Juri Reiner dhe Grigor Khandajan pas 130 punimeve që sollën në ekspozitën e titulluar “Ne e dashuruam Shqipërinë” në Tiranën e vitit 1958, një vit më pas, më 1959, ekspozuan në Moskë 215 peizazhe, portrete, etyde, vizatime dhe tablo nën titullin “Nëpër Shqipëri”. Kjo është ekspozita më e madhe me temë shqiptare që është organizuar deri tani nga autorë të huaj.

FONDI I GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE

Pjesa më e madhe e atyre pak veprave të artit, të ruajtura nga ekspozitat e mësipërme, në fillim u grumbulluan te sallat e Pinakotekës që u hap në vitin 1952. Më pas u vendosën në Galerinë e Arteve të themeluar më 1954, ndërsa prej vitit 1974, kur u ngrit godina e re më e madhe në qendër të kryeqytetit, me ato vepra u krijua fondi i autorëve të huaj në Galerinë Kombëtare të Arteve. Aty u grumbulluan po ashtu krijime të tjera artistike që vlerësoheshin si pjesë e trashëgimisë kombëtare. Në atë koleksion të autorëve të huaj bënin pjesë edhe tablo me motive të ndryshme, përveç atyre me temë shqiptare.

Sipas listës së inventarit të vitit 1996, në Galerinë Kombëtare të Arteve në

Adelmo Manna, *Peizazh me dele në Tiranë*, 1931, Galeria Kombëtare e Arteve, TiranëHans Troschel, *Portret malësori*, litografi, GKA, Tiranë



Gianni Remuzzi, *Skulpturë e vitit 1927*, Banka Kombëtare Tregtare, Durrës, foto G. Domi

Tiranë ndodhshin 137 vepra të autorëve të huaj, 79 me temë shqiptare dhe 38 me motive të tjera. Ky është i vetmi koleksion shtetëror që kemi deri tani me krijime në pikturë, në grafikë dhe vizatime.

Gjatë studimit në fondin e pa ekspozuar dhe në arkivin e galerisë, bëhet më i qartë klasifikimi i veprave, sipas kohës së realizimit, drejtimit artistik, si dhe mënyrës sesi janë bërë pjesë e trashëgimisë shqiptare. Mund t'i ndajmë në tri grupime kryesore. Në të parin futen krijimet e ruajtura nga ekspozitat e periudhës së mbretërisë dhe viteve të Luftës së Dytë Botërore. Disa prej autorëve më të njohur të kësaj ndarjeje janë Mario Ridola (1890-1972), drejtues i Shkollës së parë të Vizatimit në Tiranën e vitit 1932, Hans Troschel (1899-1979), Georges Popoff (1900-?) dhe Hans Kemmerich. Nga Ghigo Tommasi (1906-1997) ruhen njëmbëdhjetë peizazhe, ndërsa dhjetë tablotë e Giovanni Mancini-t (1902-1984) dëshmojnë historinë e dhembshme të vetë piktorit. Pasi ngriti studion në Durrës, pikuroi nëpër disa zona të vendit dhe hapi ekspozitën në Tiranë, Mancini u dashurua me korçaren Vagjeli Polena, u martuan dhe u bënë me një vajzë. Por pas



Giovanni Mancini, *Peizazh nga Tirana*, 1943, GKA, Tiranë

bombardimeve gjermane në qytetin e Durrësit në tetor të vitit 1943 familja u nda përfundimisht. Shumë vjet më vonë në biografinë e Mancini-t është shkruar se "gjatë kohës që lundronte me anije për të pikturuar e njoftojnë se nga bombardimet gjermane në Durrës rrënohet pallati ku ndodhej apartamenti i tij dhe i vritet gruaja bashkë me vajzën disamuajshe. Sapo afrohet në port, zihet rob nga

gjermanët dhe përfundon në kampet naziste. Në qershor të vitit 1945 kthehet në Itali. I demoralizuar nga humbja e vajzës, e gruas dhe e veprave të artit, i dërmuar nga torturat në kampet e përqendrimit, mbyllet për disa vjet në vetvete, në qytetin e tij të lindjes, në Manfredonia. Më pas, gradualisht, rifilloi të pikturojë dhe të ekspozojë". Ndërsa e shoqja tregonte se "atë ditë kur Mancini po udhëtonte në det, anija

u bombardua nga gjermanët dhe ai u vra. Pas vitit 1945 u kthye në familjen e prindërve në Tiranë. Disa vjet më vonë u martua në Elbasan dhe punoi si arsimtare deri ditën që ndërroi jetë. Sa ishte gjallë Vangjelia nuk e mori vesh se burri i saj jetonte dhe pikturonte në Itali"³. Edhe Mancini, nga ana e tij, nuk mundi ta shohë më gruan që dashuroi në Shqipëri, po ashtu dy "krijesat" më të çmuara të jetës së tij, vajzën që u rrit në mungesë të babait dhe tablotë e shumta që i mbetën në studion e Durrësit. Nga kjo lidhje vazhdon të jetojë vajza e tyre, ndoshta edhe nipër apo mbesa, që ende nuk e dinë lidhjen me piktorin Mancini.

Veprat e grumbulluara midis viteve 1945-1965, që i takojnë grupimit të dytë, janë fare të pakta, në krahasim me pikturat e shumta që u realizuan dhe u ekspozuan gjatë kësaj periudhe. Thuajse të gjitha punimet janë krijuar sipas metodës së realizimit socialist, që mbizotëronte atë kohë në të gjitha vendet e Bllokut të Lindjes. Tablotë që ruhen nga ato vite u takojnë piktorëve György Kohán (1910-1966), Yuri Podliaskij (1923-1987), Willi Neubert (1920-2011), Stojan Anastasov, Viktori Puzanova (1893-1967), Cen Shu Lian, Liu Hien Suk dhe Maj Vaj Hion.

Brenda këtij grupimi futen edhe krijimet e realizuara nga piktori belg Léo van Droogenbroeck (1905-1995), piktori japonez Inosuke Hazama (1895-1977) si dhe piktori francez Boris Taslitzky (1911-2005), të cilat paraqesin interes të veçantë për historinë e zhvillimeve artistike në vendin tonë. Ardhja e këtyre artistëve pikërisht në vitin 1965, tre vjet pasi u mbyllën përfundimisht ekspozitat nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të Lindjes, midis piktorëve shqiptarë krijoi idenë se po çelej një hapësirë e re me artin perëndimor. Po atë vit në Klubin e Shkrimtarëve dhe të Artistëve në Tiranë ishte hapur edhe një ekspozitë me riprodhime nga Picasso, Van Gogh dhe artistë të tjerë perëndimorë. Por veprimtari të tilla nuk u përsëritën më. Deri nga fundi



Boris Taslitski, *Vajzë shqiptare*, 1957, GKA, Tiranë



Giuseppe Gronchi, fragment nga relievi i vitit 1940, Shtëpia e Lindjes "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë



Liu Hien Suk, *Peizazh nga Himara*, 1965, akuael, GKA, Tiranë

viteve '80 në Shqipëri nuk u hap asnjë ekspozitë prej autorëve të huaj.

Grupimi i tretë përbëhet nga veprat e mbledhura prej koleksioneve private gjatë dy periudhave. Pjesa më e madhe prej tyre janë trashëgimi nga familje të pasura, piktura të blera nëpër ekspozita apo koleksione të ndryshme nëpër Europë. Tri prej këtyre tablove, dy peizazhe dhe një portret, i takojnë piktorit të shquar rumun Nicolae Grigorescu (1838-1907). Në këtë grupim bën pjesë edhe portreti i një plaku, që vlerësohet si piktura më e çmuar nga i gjithë fondi shqiptar i autorëve të huaj. Deri në vitin 1982 kartela e regjistrimit në galeri ishte me etiketën "Nga shkolla e Rembrandt-it". Në nëntor të po atij viti u botua një artikull i gjatë nga A. Kondo ku përshkruhet historiku i ardhjes së kësaj vepre në Shqipëri⁴. U paraqitën të dhëna të plota dhe argumente serioze se tabloja është pikturuar nga vetë mjeshtri i shquar Rembrandt van Rijn (1606-1669). Pas këtij artikulli u bënë kërkime e studime të posaçme, u krye restaurimi i plotë nga specialistë të Institutit të Monumenteve të Kulturës, u bënë analiza dhe ekspertiza të ndryshme për të vërtetuar autorësinë. Më 7 shkurt të vitit 1983, me pjesëmarrjen e restauratorëve dhe specialistëve të tjerë, në prani të artistëve dhe të ftuarve të ndryshëm, u paraqitën relacione me shkrim, skica, diapozitiva, krahasime mineralogjike me vepra të tjera të Rembrandt-it dhe u arrit në përfundimin se piktura është origjinale dhe i takon mjeshtrit të madh. Por as në Shqipërinë e izoluar të asaj kohe, as tani në vitet e tranzicionit ende nuk është bërë verifikimi i plotë nga specialistë të huaj, njohës të veprave origjinale.

STATUJA, MOZAIKË DHE RELIEVE

Veprat në skulpturë, në mozaik dhe në relief, të vendosura në disa prej godinave që u ngritën gjatë viteve '30-'40 të shekullit të kaluar, përbëjnë një koleksion tjetër të rëndësishëm. Janë realizuar nga autorë të njohur italianë. Midis krijimeve më të bukura janë veprat e skulptorit Alfredo Biagini (1886-1952) që erdhi në Shqipëri pikërisht në kohën kur vlerësohej midis artistëve më të njohur në Itali. Në vitin 1936 arkitekti i njohur Vittorio Ballio Morpurgo (1890-1966) po ndërtonte selinë e Bankës

Qendrore të Tiranës dhe në pjesën e brendshme të fasadës kryesore kishte menduar të vendoste disa relieve në skulpturë. Figurat që gdhendi skulptori Biagini, të grupuara sipas motiveve të ndryshme, të vendosura në harmoni me tullat dekorative që krijojnë lidhjet midis relieveve, duken si të jenë skalitur direkt në sipërfaqen e fasadës. I vlerësuar edhe më parë për ndjeshmëri në krijimin e frakturave plastike, si dhe për kalimet e buta të formave të lakuara, Biagini ka rilevuar figura të bukura dhe elegante, ku ndihet po aq një ritëm i brendshëm e natyral midis trupave të zhveshur dhe drapërive të fustaneve

të gjata e veshjeve të tjera femërore. Kur përballesh me ato relieve, ndihet atmosfera mikpritëse, dëshira për të hyrë në mjediset e brendshme të bankës dhe për t'i kundruar ato me qetësi.

Sapo futesh në ambientet e brendshme ndeshesh me një mjedis tjetër akoma më të bukur. E gjithë sipërfaqja ballore e hollit kryesor është e mbushur me mozaikë shumëngjyrësh. Pas përvojës disavjeçare në vendin e tij, piktori Giulio Rosso nëpërmjet pllakëzave të vogla me ngjyra të larmishme ka realizuar imazhe të ndryshme me subjekte nga bujqësia, nga ndërtimi e aspekte të tjera të jetës, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën dhe japin së bashku, si tërësi kompozicionale, përfytyrimin e një afresku të madh dekorativ, ku simbolika dhe pamjet natyrale krijojnë harmoni të plotë. Kështu, në vitin 1932 kryeqyteti shqiptar u bë me një nga ndërtesat më të bukura, e projektuar dhe dekoruar me relieve dhe mozaikë prej artistëve të njohur të Italisë fqinje, me traditat e saj të pasura në artet vizuale.

Në koleksionin e veprave monumentale në Shqipëri bëjnë pjesë edhe krijimet e dy artistëve të njohur të fillim shekullit XX në Itali. Skulptori Giuseppe Gronchi (1882-1944) me titullin "Akademik Nderi", pasi punoi për dekorimin e Bibliotekës Kombëtare të Firences dhe në godina të tjera publike, krijoi një vepër të re në Tiranë. Gjatë viteve 1939-1940, Gronchi realizoi relievin në përmasa të mëdha për një nga godinat e saponërtuara të asaj kohe, sot Shtëpia e Lindjes "Mbretëresha Geraldinë". Ndërsa skulptori Gianni Remuzzi (1894-1951), i vlerësuar në Itali për statujën nudo të një gruaje, të ekspozuar në Bienalen XXII të Venecias, krijoi një skulpturë tjetër nudo për ta vendosur në Shqipëri. Në vitin 1927, kur përfundoi ndërtimi



Cen Shu Lian, *Shqiponja*, GKA, Tiranë



Vicenzo Gemito, *Portret fëmije*, GKA, Tiranë

i bankës në Durrës sipas projektit të arkitektit Vittorio Ballio Morpurgo, Gianni Remuzzi solli krijimin e tij nga Italia. Skulptura u vendos mbi çatinë e faqes ballore të ndërtesës. Prej atij viti kjo vepër e gdhendur në mermer vazhdon të qëndrojë mbi godinën e Bankës Kombëtare Tregtare në Durrës, si e para dhe vetmja vepër e atij lloji që është vendosur deri tani në qytete shqiptare.

KOLEKSIONI PËR VILËN MBRETËRORE

Koleksioni i tretë i fondit shqiptar përbëhet nga mbi 20 tablo në ngjyra vaji dhe në tempera, që u sollën në vitin 1940 nga koleksione të ndryshme italiane për mjediset e vilës mbretërore në Tiranë. Në këtë grupim bëjnë pjesë vepra nga autorë të shquar të artit botëror. Kur u vendosën për herë të parë në muret e asaj godine, krijuan pamjen e galerisë së artit, që ende nuk ishte ngritur në Shqipëri. Por pas vitit 1945 ato u hoqën nga muret e vilës, sepse tematika e tyre nuk përshtatej me “frymën e re revolucionare” që filloi të bëhej pjesë e situatës social-politike të vendit. Nga ajo kohë edhe godina u quajt Pallati i Brigadave, emër që përdoret edhe sot krahas emërtimit të ri Pallati Presidential. Gjithsesi, për vlerat e dukshme piktorike si dhe për emrat e mirënjohur të autorëve, tablotë e këtij koleksioni fatmirësisht u ruajtën të paprekura. Në vitin 1967, një komision i përbërë nga artistët e njohur Odhise Paskali, Foto Stamo dhe Vilson Kilica, u ngarkua për studimin dhe përcaktimin e autorëve të veprave të artit të atij koleksioni. Sipas një relacioni që ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit, komisioni konstatoi se “19 prej atyre tablove konsiderohen vepra të rëndësishme arti”. Sipas gjykimit të artistëve, gjashtë tablotë e para, të punuara me tempera, janë realizuar nga piktori i njohur Pietro da Cortona (1596-1669). Të gjashta janë me motive mitologjike, me titujt *Zeusi*, *Diana*, *Apolli*, *Mërkuri*, *Marsi* dhe *Venusi*. Veprat e tjera, sipas nënshkrimit të anëtarëve të komisionit, u takojnë autorëve të rëndësishëm të artit botëror. Tabloja *Adami dhe Eva*, siç është shkruar në anën e pasme të telajos, është e mjeshtrit të shquar Tiziano Vecelli (1487-1576). Edhe për pikturën *Krishti në torturë* ata kanë firmosur se i takon po këtij autori. *Shën Mëria dhe Krishti* gjykohej si vepër nga Antonio da Correggio (1489-1534), ndërsa për tablonë *Çlirimi i një shenjtori* mendojnë se është e mjeshtrit Peter Paul Rubens (1577-1640). Veprat e tjera janë peizazhe dhe natyra të qeta. Pjesë e këtij koleksioni janë edhe krijimet e skulptorit Antonio Maraini (1886-1963) që u realizuan posaçërisht për ish-Vilën Mbretërore. Gjatë vitit 1940, në bashkëpunim me arkitektin Gheraldo Bosio (1903-1941), Maraini projektoi dhe realizoi dy statuja në mermer dhe një relief në përmasa të

mëdha për mjediset e brendshme, si dhe katër statuja në mermer dhe një në bronz për kopshtin rreth vilës.

Pas vitit 1990 pikurat që u hoqën më 1945 u vendosën përsëri në mjediset e Pallatit Presidential. Bashkë me skulpturat, reliefet, mozaikët dhe veprat e tjera nëpër godinat që përmendëm më sipër, si dhe tablotë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, sot ato çmohen si pjesë e trashëgimisë kombëtare.

Kohët e fundit, duke filluar nga vitet '90 të shekullit të kaluar janë krijuar disa koleksionistë të rëndësishëm shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit. Përmes tyre po pasurohet më shumë fondi shqiptar i autorëve të huaj.

Nisur edhe nga numri i madh i veprave që ekzistojnë, do të dëshironim të kishim më shumë nga pikurat me temë shqiptare për muzetë dhe galeritë tona të arteve, por edhe atje ku janë, të ekspozuara nëpër galeri dhe muze të njohur të artit, si dhe në koleksione publike apo familjare nëpër botë, ato flasin gjithnjë për Shqipërinë, zgjojnë biseda për natyrën, për njerëzit, zakonet, veshjet apo traditat e shqiptarëve.

1. Kuqali, A.: *Ekskursioni i grupit t'artistëve polakë në vendin tonë*, revista “Nëntori”, nr. 11, Tiranë, 1955, f. 172.
2. *Il Calendario 2009, dedicato al pittore Giovanni Mancini*, Citta di Manfredonia, 2008.
3. *Shënime nga bashkëbisedimi me Sofika Stari (koleksioniste dhe e afërt e Vangjeli Borovës, gruas shqiptare të piktorit G. Mancini)*, Tiranë 2008, dorëshkrim, arkivi personal F. H.
4. Kondo, A.: *Një portret i Rembrandit në Shqipëri*, gazeta “Drita”, Tiranë, 14 nëntor 1982; Sopi, E., Thaçi, F.: *Mbi një pikurë të panjohur të Rembrandit*, revista “Monumentet”, nr. 2, Tiranë, 1985, f. 43-44.



Stojan Anastasov, *Himara e vjetër*, karbon, 1958, GKA, Tiranë



Léo van Droogenbroeck, *Rruga e Durrësit*, 1960, GKA, Tiranë



Willi Neubert, *Peizazh nga Tirana*, 1958, GKA, Tiranë

Disa ditë më parë më erdhi një libër nga Spanja, i botuar në Madrid, në një format luksi, nën kopertinën e të cilit ishin “fshetur” 106 perla të kulturës shqiptare, 106 përralla të përzgjedhura nga qindra të tilla, të mbledhura në më shumë se tre shekuj. Dërguesja fisnike, përkthyesja dhe studiuesja e letrave shqipe, MARIA ROCES GONZALES, më thoshte se ky libër ishte realizimi i një ëndrre dhjetë vjeçare. Ëndërr e saj dhe e bashkëshortit RAMON SANCHEZ LIZARRALDE, përkthyesit të famshëm të letërsisë shqipe, veçmas të veprave të Ismail Kadarese, nëpërmjet të cilave, shkrimtari ynë i madh u bë shumë i njohur për lexuesit në gadishullin iberik dhe mori edhe çmimin Princi i Asturias, më i larti i Spanjës për autorë që nuk shkruajnë në gjuhën spanjolle.

Ramon Sanchez botoi 28 përrallat e para shqiptare që në vitin 1994 dhe dhjetë vite më vonë edhe dhjetë të tjera. Ai kishte një projekt dhe një ëndërr për të botuar jo vetëm pjesën më të mirë të përrallave shqiptare, por edhe Ciklin e famshëm të Kreshnikëve, me këngët legjendare të Mujit dhe Halilit, Gjergj Elez Alisë dhe kreshnikë të tjerë. Por, me vdekjen e Ramon Sanchesit, projekti u bë një “këngë e ndërprerë”.

Guximshëm, Maria Rocës vendosi ta vazhdojë. E apasionuar pas gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare,

Botohet në Spanjë libri E BUKURA E DHEUT, me 106 përralla shqiptare, të përzgjedhura nga studiuesja dhe përkthyesja MARÍA ROCES GONZÁLEZ mes qindra përrallave të botuara që nga viti 1854 e deri më sot

GJERDAN PERLASH TË KULTURËS SHQIPTARE NË SPANJISHT

Nga Namik Dokle





krahas vazhdimit të përkthimit të veprave të Kadaresë dhe autorëve të tjerë, ajo vazhdoi pa ndërprerë punën për njohjen dhe përkthimin e përrallave më të mira shqiptare, duke studiuar gjithë historinë e tyre, që nga mbledhësit e herëshëm të folklorit shqiptar, me fillesë në vitin 1635, me botimin e pesë përrallave të para në vitin 1854, nga konsulli austriak në Janinë, Johann Georg von Hahn e deri në ditët e sotme. Ato pesë përrallat e para që panë “dritën e librit”, habitën edhe njerin nga vëllezrit GRIMM, të famshmit e përrallave gjermane, Wilhelmn. Ai shkroi: është tronditëse afria e këtyre përrallave me ato gjermanet. Vetëm me një ndryshim; përrallat shqiptare, atëherë, por edhe një shekull më vonë, tregoheshin në vatrat shqiptare, nga njerëz që nuk dinin shkrim dhe këndim, nga pleq që tymosnin çibukun, apo plaka që thurnin triko. Është për këtë arsye që ato janë aq origjinale, të pastra dhe të pandikuara nga letërsia e kultivuar. Ndoshta edhe ky vlerësim do ta ketë nxitur Hahnin që, dhjetë vjet më vonë, në librin e tij Përralla greke dhe shqiptare të përfshinte edhe nëntë përralla të tjera shqiptare dhe 25 motërzime, gjithashtu në shqip.

Përveç përrallave të botuara nga Ramon Sanchez Lizarralde, të gjitha përrallat e tjera të këtij libri botohen për herë të parë në Spanjë. Siç njofton përkthyesja María Rocés në parathënien e librit, në të janë përfshirë pesë përrallat e para të Hahnit (Jena,1854), gjashtë të tjera te botuara nga konsulli francez Auguste Dozon (Paris, 1879), plus katër motërzime, në vazhdim katër të botuara nga filologu danez Holger Pedersen (1895) i cili mbledhi edhe një motërzim në të folmen e Çamërisë; një përrallë nga ato që albanologu i shquar Gustav Meyer mbledhi në vitin 1888 dhe një tjetër e folkloristit të madh Thimi Mitko, me tre motërzime. Arbëreshët e Greqisë përfaqësohen me katër përralla të botuara nga Petros Furiqis, botuar në Athinë, në vitin 1933. Dy përralla të tjera janë të arbëreshve të Italisë.

Nga mbledhësi dhe studiuesi i shquar i folklorit, Donat Kurti (që kaloi 17 vite të jetës në burgjet komuniste) janë përfshirë në librin e Maria Rocés González plot 29 përralla. Një pjesë tjetër e rëndësishme janë përzgjedhur nga botimet e Institutit të Folklorit, i cili, pas vitit 1954, me ekspeditat e shumta që vazhduan për shumë kohë, pat mbledhur 6.700 faqe të prozës popullore, 23.000 proverba, 750.000 vargje këngësh, 3.100 inçizime



muzikore etj. Libri kompletohet edhe me disa përralla të mbledhura në Kosovë dhe të botuara në librin Antologjia e përrallave shqiptare, përgatitur nga Anton Berisha dhe Myzaferë Mustafa. Me gjithë këtë punë voluminoze studimore e përzgjedhëse, me verifikimet në terren (deri në Vermosh), me përkthimin dhe botimin për herë të parë në gjuhën e Servantesit të përrallave shqiptare, pa asnjë hezitim, do ta cilësoja Maria Rocés Gonzalesin me termin e përdorur dikur nga rilindasi Thimi Mitko: Bleta shqiptare.

Jam i bindur që lexuesit spanjollë do të mrekullohen me këto perla shqiptare, të përkthyer mjeshtërisht dhe të botuara me një përkujdesje të veçantë nga botuesja ANA KRISTINA HERREROS, që meriton gjithë falenderimet. Po ashtu meriton përgëzime piktori JESÚS GABÁN që ka bërë ilustrimet e librit. Për përkthyesen, siç shprehet ajo vetë, kjo është puna që i ka dhënë më shumë kënaqësi. “Ka qenë një sfidë e bukur,- thotë ajo.- Përrallat shqiptare përshfaqin një realitet mitik dhe magjik. Edhe pse tregohen në dialekte të ndryshme, gegnisht, toskërisht, apo në të folmen çame, ato ruajnë një përmbajtje dhe mjeshtëri të përbashkët, gjë që, për nga forma, figurshmëria, motivet dhe përmbajtja, i dallon dukshëm nga përrallat e tjera ballkanike dhe mesdhetare.”

Lexuesit e një letërsie me imagjinatën tipike donkishoteske do të gjenden si në ujërat e veta brenda përrallave shqiptare. E bukura e Dheut dhe zanat, me siguri do t’u kujtojnë Dulqinjën, dhe katallani, divi, kuçedra do t’u kujtojnë “viganët” me të cilët luftonte heroi i tyre, Don Kishoti. Fuqia metaforike e metamorfozës në përrallat shqiptare e kapërcen ku e ku metamorfozën kafkiane. “ Merre këtë ujë, laje fytyrën dhe do të bëhesh ajër...” thuhet në një prej përrallave e vazhdojnë më tej shndërrime të shumta e të jashtëzakonshme, për të arritur tek ajo “lufta e shndërrimeve” mes njeriut dhe djallit, gjatë së cilës, pas shumë metamorfozave të tjera, njeriu u bë grurë dhe yshti djallin të bëhej pulë për ta çukitur dhe...fap!, njeriu bëhet skifter dhe e ha pulën.

Për të mos u zgjatur në detaje të tjera, po kthehem edhe një herë tek të famshmit Vëllezrit Grimm, emblemat e përrallave gjermane. Një nga më të famshmet e tyre është përralla Hänsel dhe Gretel. Ngjan me të përralla jonë Gjoni dhe Mria, botuar për herë të parë nga Donat Kurti. Por në fundin e përrallës, ndërsa Hänsel dhe Gretel kthehen në shtëpi me çantat mbushur plot me gurë të çmuar dhe vazhdojnë jetën të lumtur, në përrallën shqiptare, Gjoni dhe Mria, shndërrohen në dy zogj, për të kënduar vëllau natën dhe motra ditën. A nuk iu duket kjo mbyllje e jashtëzakonshme dhe e papritur shumë më e padëgjuar, më imagjinative dhe më poetike nga ajo e variantit gjerman?

Maria Rocés Gonzalesit i duket se po, me një PO të madhe, prandaj punoi vite të tëra, me pasion dhe dashuri, për t’u dhënë lexuesve spanjollë TË BUKURËN E DHEUT, që shkon nga Shqipëria në Gadishullin Iberik.

Martin Camaj (1925 – 1992) është ndër shkrimtarët tanë më të shquar bashkëkohorë. Veprimtarinë e tij letrare e nisi në Prishtinë, e vazhdoi në Romë dhe në Mynih të Gjermanisë¹. Edhe si gjuhëtar na la trashëgim një varg punimesh e studimesh me vlerë. Po kujtoj këtu vetëm studimin për “Mesharin” e Gjon Buzukut², “Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries³” dhe La *parlata arbëreshe di San Costantino Albanese*⁴.

Në studimin e tij monografik “Vepra letrare e Martin Camajt, të botuar për herë të më 1994 në Kozencë⁵, prof. Anton Nikë Berisha, shkruan: “Në letërsinë tonë bashkëkohore janë të paktë shembujt që vepra letrare e një autori, përkatësisht qasja dhe interpretimi i saj, të vënë para provave kaq të rënda si ajo e Martin Camajt. Ky mendim për ligjet nga fakti se krijimtaria e tij letrare është komplekse: ka një botë burimore e të pasur tematike-motivore e poetike dhe cilësohet me një strukturë të veçantë dhe të mëvetësishme gjuhësore shprehëse dhe me një sistem origjinal dhe të ndërliqshëm kuptimor. Si e këtillë edhe receptimi i saj kërkon shumë më tepër përkushtim e dije sesa leximi i një vepre të zakonshme letrare. Them kështu për arsye se vepra e tij poetike është, para së gjithash, fryt, me një anë i aftësisë krijuese e përfytyruese (imagjinative) dhe, më anë tjetër, i përkushtimit të madh krijues. Në veprat e tij Camaj zbatoi atë që theksonte me të drejtë Lasgush Poradeci: “[...] poeti duhet të jetë kursimtar i madh në fjalë, të thotë maksimumin e ndjenjave me minimumin e fjalëve⁶”.

Në botimin e dytë të këtij studimi të bërë në Tiranë më 2000⁷, prof. Berisha boton dhe dy letra të Martin Camajt⁸ dhe njëherit bën të ditur edhe për faktin se ka rreth 50 letra që shkrimtari i madh ia kishte nisur atij, letërkëmbimi që kishte zënë fill nga gjysma e dytë e janarit të vitit 1979 e vazhdon deri në maj të 1991 - shit.

Në letrat e Martin Camajt dërguar Anton Nikë Berishës, që po botohen për herë të parë në libër, shpaloset thellësisht bota e shkrimtarit dhe rrjedha e veprimtarisë së tij, jo vetëm në fushën e letërsisë, po dhe në atë të gjuhësisë dhe më gjerë.

Letrat ndriçojnë një varg dukurish që lidhen me jetën e tij, në Shqipëri, në Beograd, në Romë dhe në Mynih,

¹ Vepra në gjuhën shqipe të Martin Camajt: *Nji fyll ndër male*. Prishtinë 1953; *Kanga e vërrinit*. Prishtinë 1954; *Djella*. Romë 1958; *Legjenda*. Romë 1964; *Lirikë mes dy moteve*. München 1967; *Rrathë*. München, 1978; *Njeriu më vete e me tjerë*; München 1978; *Dranja*. München 1981; *Shkundullima*. München 1981; *Poezi* (1953-1967). München 1981; *Karpa*. München 1987; *Pishtarët e natës*. “Buzuku”, Prishtinë 1991; *Në hijen e gjarpnit*. “Jeta e re”, Prishtinë 1991; *Palimpsest*. München 1991; *Kandili argjandit*. *Dramë*. “Radhontjtë e Zjarrit” n. 17. Kozencë 1993; *Djella* (Versioni i përpunuar). “Buzuku”, Prishtinë 1994.

Vepra të përkthyer: *Poesie*. Trans. Francesco Solano. Centro internazionale di studi albanesi “R. Petrotta” Facoltà di Lettere e Filosofia Università Di Palermo, Ediprint-Siracusa, Palermo 1985; *Selected Poetry*. Trans. Leonard Fox. New York University Press, New York-London, 1990; *Gedichte*. Trans. Hans-Joachim Lanksch. Kyrill & Method Verlag, München 1991; *Palimpsest*. Trans. Leonard Fox. München - New York, 1991.

² Martin Camaj, *Il “Messale” di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi*. “Shëjzat”, Roma 1960.

³ *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries* (Collab. On and translated by Leonard Fox), Otto Harrassowitz, Wiesbaden 1984; *Fjalëformimi në gjuhën shqipe* (Tema e habilitacionit).

⁴ Martin Camaj, *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese*: in provincia di Potenza. Front Cover. CELUC 1993.

⁵ *Vepra letrare e Martin Camajt*. “Radhontjtë e Zjarrit”, n. 18. Kozencë, 1994. Botimi i dytë i rishikuar dhe i shtuar, “Lajmtari”, Tiranë 2000. Botimi i tretë i plotësuar dhe i shtuar “Princi”, Tiranë 2010. Botimi i katërt me ndryshime Shtëpia botuese “Beqir Musliu”. Gjilan 2020.

⁶ Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*. Monografi. Botimi i tretë i plotësuar dhe i shtuar “Princi”, Tiranë 2010, f. 19.

⁷ Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*. Monografi. Lajmëtar 2000.

⁸ Faqe 151 – 155.

Rreth librit të prof. Anton Nikë Berishës, *Martin Camaj: “Letërsia ashtë jeta ime e vërtetë”*. – 49 letra të tij – dhe teksti i bisedës i vitit 1990, Shkup 2021

LETRA QË SHPALOSIN NË THELLËSI BOTËN DHE VEPRIMTARINË LETRARE DHE GJUHËSOR TË MARTIN CAMAJT

Nga Skënder Asani

shfaq mendime për veçantitë e stilit, rëndësinë që i kushtoi gjuhës, pastaj për përkushtimin dhe mënyrën e hartimit dhe te botimit të veprave, po shpreh dhe dëshirën që ato të përhapen në trojet shqiptare, sidomos në Shqipëri, ku vepra e tij ishte ndaluar. 4 shkurt 1979: “Qëllimi dhe qëndrimi i vërtetë imi ashtë letërsia: nuk ka pasë një ditë tash 50 vjet e këndej që nuk e kam formulue me mend apo me shkrim së paku një ide letrare: letërsia ashtë jeta ime e vërtetë” (Nga letra: Lenggries, 4. 2. 1979.)

Në letra e Martin Camajt jepet, siç u tha, dhe çështje e të dhëna konkrete për punën që ka bërë me disa nga veprat e tij letrare, siç thuhet në letrën e dt. 10 maj 1991: “Djella i përket fazës së parë në ‘kapërcyell’ ku lidhet tradita letrare me stilin specifik (ose me mesazhin specifik timin). Andaj ndonëse në dukje, duket gjà e thjeshtë, struktura e kësaj vepre dhe pyetjet që vehen janë fort të kapërthyme. Aspekti poliedrik mue si autor më ka shti në probleme që jam mundue t’i shkoqis në të gjitha veprat që ndjekin. Disa njohës letrarë të kujdesshëm, bashkë me Dranja (dy emna femnash!) e gjykojnë Djellen si ‘hoher Punkt’⁹³ në krijimtarinë time.

Por... në përpunimin për edicionin e

⁹ ³ Pikë e lartë, kulm.

dytë *Djella* u integruë plotësisht në veprat e ‘pjekunà, pa e humb freskinë, si thashë, të venës së ré. ‘Përpunimi’ ka kaluë nëpërmjet atij procesi krijues të një vepre origjinale, andaj gjithçka zgjati një vjet, dy e tre kapituj në muej, pa u ngutë. *Djella* doli 77 faqe në dorëshkrim.

Tash në fund më duket se kjo variante do të dalë me një originalitet që s’kanë veprat tjera. Ashtë bà përmes *prozës* një hymnizim *poezisë*”. (Lenggries, 10 maj 1991).

Në letra Camaj shpalos dhe qëndrimin e tij për marrëdhëniet me miqtë nga Prishtina, ku kishte botuar dhe dy veprat e para me poezi “Nji fyll ndër male” (1953) dhe “Kanga e vërrinit” (1954): “Kuvenduëm disa herë edhe për qëndrimin tim kundrejt botës sonë; nuk e di sa ka qenë e nuk ka qenë e drejtë, por gjithherë jam përpjekë të jem korrekt (prap po i shmangem fjalës ‘dashuni për vend e popull!’) Qe, tek tema ku due me dalë pa lakime: ta kam thanë dhe besoj se nuk ta kam shkruë, dëshira ime ka qenë gjithmonë me ndejë në kontakt me punën e përmes punës e zejes me ju. Ky kontakt duhet thanë se me ju në Kosovë e me miq e shokë të shkollës të Belgradit¹⁰ etj., nuk

¹⁰ Në Beograd Martini mbaroi studimet dhe aty njohu shumë shqiptarë të Kosovës, të cilët studionin atje, ndër të cilët edhe Anton Çetën, Adem Demaqin, Bashkim Fehmiun, Gani Lubotenin, Zekeria Canën etj.



ashtë shkëputë: kur jemi takue mbas dhjeta vjetësh, si unë si ju jemi kujtue se koha e rrethanat *njerëzisht* nuk na kanë ndà.

Me ju në Prishtinë, natyrisht, kam pasë gjithnjë tjera dëshira kontakti, por kam qenë edhe pakëz i rezervuëm, shpesh që mos të keqkuptohet dëshira ime e kontaktit, ndonëse nuk kanë kaluë kurrë ma se dy vjet pa ia qitë ndër mend se due me mbetë mik e dashamirë pa zhigla. Kjo ishte lehtë fort sepse dihej nga të dyja palët se kontakti mbeste prore në një fushë, në letërsi e shkencë.

Me kohë jam ftohë fare (prap rezervël) sepse kolegët (disa mocatarë) e kanë vu theksin në kontakt me mue në bazë levantine, na malësorët kishim me i thanë fjalët e mira e gurët në strajcë. Shndërrimi i mendimeve me ty qe je një brezni ma e re më ka ba fort mirë dhe për këtë të falnderoj fort e fort!” (Lenggries, 12. 5. ‘85).

Në letrën e dt. 19 shkurt 1985 Camaj i shkroi Berishës midis të tjerash: “[...] të falnderoj për letrën tande të përzemërt! Edhe për mue ka qenë një diskutim i dendun dhe fort frytdhanës me Ty, ma së pari sepse ti e ke lodhë mendën dhe tue e lodhë (e kam fjalën në krahasim me gjeneratën) me të tashmen thosopo, po edhe me të kaluëm. E ardhmja thonë malesorët “ashtë në dorën e Zotit”. Gjaja që ban kuvendimin të frytshëm mandej ashtë sinqeriteti dhe unë e çmoj deri aty ku s’vete ma. Ju jeni të rij, por jeni ballafaque me probleme ekzistenciale heret e jeni pjekë. Ti prej takimi të parë deri tash ke ba përparime në çdo pikëpamje dhe kjo më nxitë në kuvendim. Të lumtë! Shumëkush kënaqet me plotësue disa anë formale gjatë përgatitjes intelektuale e për thelbin e punës as që lodh menden!” (Lenggries, 19. 2. 85).


Në letra ka dhe ndonjë porosi, edhe pse Martini u bishtrënon atyre që janë të drejtpërdrejta: “[...] po due me thanë diçka tjetër se gjuha që kemi dhe arti i popullit tonë... mund të na qesë në dritë gjithsesi. Mundonju, thueju shokëve, ta shkruëjnë mirë shqipen!”

Vlerë më vete kanë dhe tri letrat e Anton Nikë Berishës nisur Camajt, përmes të cilave dëshmohet dukuritë që janë shtruar midis tyre, mënyra dhe stili i letërkëmbimit midis këtyre dy intelektualve tanë.



Edhe botimi i tekstit të bisedës me Martin Camajn, që botohet në shtojcën e parë, e ka rëndësinë e vet të pamohueshme. Në të jepen disa mendime e të dhëna që asnjëherë tjetër Martini nuk i kishte shprehur në mënyrë publike. Këtë gjë e thotë vetë në letrën e dt. 26 qershor 1990, të shkruar në Mynih, përmes së cilës i bën të ditur Antonin se po i niste tekstin e bisedës: “Këtu po të mbyll intervistën [...] S’kam folë asnjëherë ma qartë për veprën time e disa mendime të mia, andaj të lutem të dalë pa gabime shtypi që të citohet drejtazi nga studiuesit”.

Në fund e falënderoj prof. Anton Nikë Berishën që botimin e këtij libri ia besoi Institutit tonë.



“Kush nuk ka lexuar, në moshën 70-vjeçare ka jetuar vetëm një jetë, atë të tijën, ndërsa kush lexon ka jetuar 5 mijë vjet...” Kjo thënie e Umberto Eco-s i përshtatet më së miri Agim Baçit si lexues model i letërsisë. I njohur më së shumti si gazetar dhe kritik letrar, ai njëkohësisht është poet, tregimtar dhe novelist. Është autor i studimit “Përse e sollën Doruntinën?”, një përsiatje antropologjike dhe sociologjike mbi veprat “Prilli i thyer” dhe “Kush e sollë Doruntinën” të Ismail Kadaresë.

Ndërtuar në trajtë epistolari, “Letër Dylqinjës” i tejkalon kufijtë kanonikë të përkufizimit zhanror. Ky tekst është një bashkëbisedim intim me vetveten, një qasje origjinale që ngre pyetje ekzistenciale dhe orvatet të orientojë disa shtigje përgjigjesh, pa synuar shterimin e tyre. Si kirurgu që njeh mjeshtërisht trupin e njeriut, vepra anatomike e Baçit rreket të na zbërthejë mekanizmat ndërveprues letrar, duke u futur thellë në vetëdijen, psikologjinë dhe sociologjinë e personazhit. Marrëdhënia që krijon me personazhet e letrave të tij është intime, gjë që tregon për një njohje të hershme dhe të afërt mes tyre. - “E nderuara dhe shumë e respektuara e Tobozës, planet i ndjenjave dhe i mendjes së kalorësit të famshëm të Mançës, Dylqinjë!” - i drejtohet autori në letrën e parë Dylqinjës së Tobozës, duke i rrëfyer më tej në formë pyetjeje arsyet dhe guximin e madh në shkrimin e kësaj letrë: “Si ndihet një femër kur e duan aq shumë sa ju do juve Don Kishoti?” Ndërsa letra i drejtohet Dylqinjës, për “çudi”, përgjigja i vjen prej Don Kishotit, i cili i xhelozuar është gati ta ftojë në duel, mirëpo është këshilla e ftohtë e Sanço Pançës që i ndryshon mendje. “Unë kam arritur të kuptoj se Krijuesi i kësaj bote ka mbajtur nga të gjitha krijimet e tij dy fshehtësi, - vjen përgjigja filozofike e tij, - atë të Vdekjes dhe atë të Dashurisë: e të dyja me kushtin e vetëm që me të parën të mësohesh për ta zhvlerësuar, ndërsa të dytën ta kërkosh për ta shijuar”. Pas këtij letërkëmbimi të parë, mes tyre fillon një bashkëbisedim i gjatë, i hapur, i lirë, i natyrshëm dhe miqësor, ku pyetje të mençura kanë hak përgjigje të urta.

Po aq i gjetur është bashkëbisedimi me madamë Bovarinë, gruan që Floberi krijoi si pikëpyetje mbi botën. Kurioziteti i autorit arrin kulmin në disa çështje thellësisht intime: raporti i saj me Sharlin, çfarë e tërhoqi tek Leone dhe Rudolfi dhe, nëse i erdhi para syve fytyra e Bertës, kur ajo piu helmin vdekjeprurës. - “...Ajo që më ndodhi me Sharlin dhe të tjerët, - përgjigjet zonja Bovari, - ishte me e fortë se unë. Nuk isha e përgatitur t’u jepja përgjigje shumë gjërave përballë pasionit tim... Dhe për gratë është e rëndësishme ajo e përtejmeja, e pamundura - pikërisht ajo duhet të qëndrojë në sytë e burrit...”

Në letrën drejtuar Brutit, pyetja është më therëse se përgjigja, kurse i pyeturi më i sinqertë se pyetësi. - “...Si mundët vallë ta tradhëtonit Çezarin?” - pyet Baçi dhe Bruti i projeksonit shekspirian, autor i kamës së zgjatur në

Shënime për librin “Letër Dylqinjës” të Agim Baçit

ALKIMIA E TAKIMIT TË TEKSTIT ME LEXUESIN

Nga Namir Lapardhaja

trupin e Perandorit Çezar, përgjigjet: “... Duhet të vendosja se cili duhet të isha - dhe në vend të anonimatit zgjedha tradhëtinë”.

Në të gjitha letrat e këtij libri, autori e vendos veten në raport me personazhin, veprën apo veçanësinë e pyetjes në një marrëdhënie të atillë për t’i dhënë konotacion të universales çështjes së trajtuar. Lexuesi e kupton se pyetjet e ngritura në këtë libër janë edhe të tijat, ndaj kureshtja për të marrë përgjigjet është po aq grishëse sa befasia e pyetjeve.

E njëjta njohje e plotë, thellësi leximi, sintetizim kuptimësie dhe interpretimi, reflektohet në letrën drejtuar Çiçikovit, mbledhësit të frymëve të vdekura,


i cili në ndonjë çast të jetës së tij ka menduar se mund të mos i kishte hyrë aventurës së tij, nëse nuk do t’i kishte humbur rublat që kishte mbledhur si nëpunës dogane; Sara Mandit, gruas që jetoi për dashuri; Galli Xhimsonit, simpatikut të përbotshëm; Shvejkut, që shkakton buzagazin e duhur, që ka humbur kureshtjen për të qenë serioz dhe që prezantohet si idiot për të pasur mundësinë që të njohë njerëzit me fytyrën e tyre të vërtetë; Tolstoit për Ana Kareninën se përse i rezervoi atë fat, ngase nuk mund të ndëshkojmë dikë për shkak të dashurisë, dhe përgjigja e tij se gjithçka është brenda imagjinatës dhe “imagjinatën e një gruaje mund ta mundin vetëm dy gjëra: burri dhe

vdekja. I pari mund të bëhet ndalesë në emër të jetës. E dyta është fundi i së paarrtshmes në këtë botë që njohim”; Portretit të dashurisë, Zhuljetës dhe Romeos, mrekullisë së të gjitha historisë së dashurive; Tom Sojerit, të riut të përbotshëm, i cili të bën të kuptosh fëmijërinë dhe fëmijët e tu dhe të mëson se gabimi në kohën e duhur është sukcesi i njeriut dhe të dish kur është kjo kohë në mënyrë që të kesh mundësinë të të falin; Odisesë, të zgjuarit të Homerit, të cilit duket sikur i kërkon llogari tekta e pyet se përse udhëtimi i mahnitshëm i kthimit tek dashuria, Penelopa, është errësuar gjithnjë nga historia e Helenës; Stefan Cvajgut, që ka bërë përmes fjalëve të jetë njëkohësisht etje dhe ujë; Kontit të Monte Kristos me hakmarrjen në formë dembele të hidhërimit; Uriah Hipit, që i kërkon t’i përgjigjet se si mundet të mbahet me frymë kur e gjithë jeta e tij është përulja; Alioshës që i kërkon burimin e qetësisë dhe përgjigjen e tij se “njeriu është kudo, por na duhen sytë për t’i parë, na duhet dashuri për t’i lexuar fytyrat e tyre dhe të rrokim prej tyre atë që i bën të mirë, që i largon nga epshi dhe lakmia”; Milan Kunderës, pyetja drejtuar të cilit: “...A mund të jetë humori pjesë e protestës, e disidencës?”, ka për qëllim Ludovikun, personazhin kryesor të “Shakasë”, që detyrohet të jetë viktimë e humorit së tij, merr si përgjigje mes rreshtave: “... Njerëzit kanë nevojë t’u japin fytyrë ndjesive të tyre... Është një gjest, që herë shkon i pafiksuar e herë trondit, edhe pse është thjesht një lëvizje gjetheje pas një puhize. Duhet të mendojmë për pasionin, për lirinë, për revoltën tonë...”

Të tetëmbëdhjetë letrat e këtij libri janë një ngasje e jashtëzakonshme për një lexim të tjetërfartë të letërsisë. Janë një galeri pyetjesh jetike dhe përgjigjesh ekzistenciale që burojnë nga njohja e thellë e letërsisë së përbotshme, ku janë fshirë kufijtë kohorë dhe hapësinorë mes autorit dhe personazheve, ku letërsia merr kuptim vetëm nëse u jep përgjigje pyetjeve jetësore që ne si lexues mund të ngrejme.

“Letër Dylqinjës” është një këndvështrim i munguar, ku befasia gërshetohet me urtësinë, kureshtja me mençurinë dhe origjinaliteti me bukurinë estetike. Teksa mbyll faqen e fundit të librit, e kupton dhe ndjen të nevojshme për ta rihapur sërish librin nga e para, për ta rilexuar dhe për të gjetur në të mesazhe të thella që nuk arrite t’i gjeje më parë. Libri u vjen në ndihmë nxënësve dhe mësuesve, studentëve dhe studiuesve, pedagogëve dhe kritikëve, si një alternativë e vyer për ta lexuar ndryshe letërsinë dhe për të shkruar nëpërmjet saj atje ku nuk shkojnë dot, për të folur me atë që nuk kanë mundësi të flasin dhe për të takuar personazhe që nuk do të kishin kurrë mundësi për t’i takuar në përditshmëri.

Me “Letër Dylqinjës”, Agim Baçi na ka treguar se leximi i shumtë i letërsisë nuk të bën as më të mençur as më të zgjuar, por është aftësia individuale ajo që mund ta shndërronë nektarin e tubuar në mjaltë të ëmbël.



Ilustrimet nga Bujar Kapexhiu

Gjithmonë në ditën e Kërshëndellave kisha një dëshirë e zjarrtë të ndodhesha në shtëpinë e fëmijërisë në fshat. Bëja plane. Mendoja me detaje; kërkoja dorezat e meshinit ku ishin e ku s'ishin nëpër çanta e baule; hekurosja kapuçin e xhupit të madh dhe zgjidhja shallin më të trashë, atë që më kishte bërë dhuratë mëma, të punuar me shtiza.

Pastaj i lutesha me ditë të tëra Perëndisë që të binte dëborë. Atëherë, pasi kisha mbyllur veshët ndaj ankesave të sime shoqe; "Shko, shko, ndofta mbetesh andej rrugëve". "Nuk dëgjon, që Qafa e Thanës është e bllokuar! Vetëm me zinxhirë!?"

Dhe pastaj isoja që i mbante çupa; "Ç'lodhesh kot mama!? E ka vendosur! Edhe ta lidhësh vetë me zinxhirë, nuk mbahet."

Atëherë vija buzën në gaz. Përqafoja time bijë, pasi ky pohim i saj ishte si të thuash një lloj leje për mua dhe të nesërmen që pa gdhirë porosisja vendin në fugonin e linjës Tiranë – Bilisht.

xxx

Kur zbrita në të dalë të qytezës së vogël dhe morra udhën tek kryqëzimi i fshatrave të Devollit të Sipërm, frynte një thëllim i egër dhe ngrinte dëborë. Isha kredhur brenda xhupit prej lëkure dhe çanta më trokante pas shpine në çdo hap.

Sapo kishte kaluar mesdita dhe rrugët e ngrira të qytezës ishin thujse të boshatisura.

Herë- herë kalonte ndonjë kamion që vinte nga përtej kufirit dhe tek kthesa e Lapidarit; siç i kishte mbetur emri që në kohë, shkundte dëborë nga mushamaja e ngrirë.

-Paska rënë më shumë andej nga greku!

-Nga greku erdhi dëborë...s'është pe neve! Tha një zë i ngjirur. Ktheva kokën dhe vura re se tek stacioni i vogël i Devollit të Sipërm, kishte dhe dy- tri njerëz që prisnin për ndonjë makinë të rastit.

Nga dera e një pijetore, mbi trotuar doli dikush që i thirri bashkëfolësit tim!

-Gëzkë, hajde hajde pi një luftarake, pa do dalë ndonjë makinë për lart. Shpejt është!

Ai që quhej Gëzkë u mrol. Shfryu bulçitë U kthye nga unë dhe tha duke tundur kokën.

-Për raki, thotë! Dhe si një njeri që bezdiset edhe po t'i bëje fresk me lule, por që e dëshiron fshehtëzi dhe heshtur, u fut brenda pijetores. Mbeta vetëm në rrugë..

Nëpër degët e pemëve të ngarkuara me dëborë sa mend po thyheshin, harabelat cicëronin ngeshëm. Përgjonin që lart ndonjë vend me tokë të errët, nën avllitë e shtëpive dhe lëshoheshin vrik tatëpjetë.

Nga një oborr aty pranë, fëmijët luanin me topa bore dhe gëzonin duke vrapuar sa nga njëri cep në tjetrin..

I vështroja tërë kërshëri sikur të isha unë në vend të tyre. Kisha një lloj padurimi, ja si ai i atyre fëmijëve!

Me zi prisja të dilte ndonjë makinë që merrte rrugën përjetë Devollit. Fundja deri ku të shkonte pastaj do ta nisja udhën në këmbë për në fshat, tek nëna që priste...

Ra telefoni dhe iu përgjigja.

-Në Bilisht jam. Ja sa të dalë ndonjë makinë dhe erdha..

-Epo mirë, more bir i nënës! Bje dëborë dhe këtej! Kanë therur derrat. Do ndonjë gjë për darkë?! Verë kam pe tonës...

-As gjë, moj nënë, as gjë...

U hap dera e pijetores pas kurrizit tim.

NË PRAG TË KËRSHËN- DELLAVE

Tregim nga Andon Andoni

Ai që kishte emrin Gëzkë, erdhi dhe me zgjati një gotëzë me raki.

-Pije edhe po nuk erdhe brenda!? Se kushedi e ke me ngut? Pije se të ngroh gjoksin,-dhe u kthye me fytyrë nga pijetorja si për t'i thënë sa ishin aty brenda rreth tymit të cigareve dhe tavolinave të rakisë që; "unë e bërë timen!"

- Prandaj i themi luftarake... Buzëqesha. Po të mos isha në një ditë të tillë plot gaz, do ta kisha refuzuar por ...E mora dhe e ktheva menjëherë.

Më dogji gjoksi dhe i dhashë kapuçit pas qafe. Era më përcëlloi veshët.. Po bëhesha gati të hyja tek pijetorja dhe t'i qerasja të gjithë sa ishin aty pranë një pori me qyngjet deri në tavan, por një makinë u ndal tek këmbët e mia dhe ata tri katër -njërës që prisnin rendën pas saj.

-Për ku?

-Për në Miras?

Shoferi ishte një djalosh me mjekër të parruar dhe i veshur me një pulovër që ia nxirrte në pah muskujt e krahëve. Ishte i njohur për pasagjerët se ata të vonuarit, që nuk e dëgjuan përgjigjen e tij e pyetën?

-Meti, do shkosh lart, o!

-Jo, jo jam këtej, nga Bozhigradi!

-Për andej nga ty është!? -më tha Gëzka duke hapur derën e pijetores.

I thashë ku doja të shkoja dhe ai tha;

- Hip!

Sa u nis, me mua në vendin e parë, e lëshoi gazin ngadalë dhe vështronte për ndonjë pasagjer mbi trotuar. Shikonte me një sy vëngërosh. Nuk e kuptova në e kishte të tillë apo, teksa zgjatej për të parë pasagjerët, i zvogëlohej syri i majtë në një përpëlitje qepallash tërë sklepa.. Ende nuk merrte rrugë; por paçka, unë lëshova çantën mbi prehër dhe sytë mu mbushen me dritë të bardhë. Tani, po! Po shkoja tek nëna për kërshëndelat, ku zjarri bubulak kërciste në sobë dhe një gjym me misra të zier, shfrynte avujt më nge.

Ai ecte ngadalë. Le të ecte!. Tani unë isha në rrugën drejt shtëpisë!

-Për lart!? Ka njeri! Pyeste, përmes xhamit të hapur të derës gati duke u përkulur mbi mua, djaloshi shofer!

U ktheva dhe unë nga trotuari.

Një vajzë rreth të 20 -tave si vështroi shoferin, ktheu kurrizin dhe eci për nga pijetorja.

-Për ku je ti? E pyeta unë që isha më afër se shoferi, në krah të saj!

-Për në Menkulas,-tha vajza dhe eci

më tej si të donte të thoshte;- ç'më pyet? Nuk vij...!

-Epo hajde! Të shpiem ty, pastaj kthehem e lëmë këtë xhaxhanë! Vura re kur foli se dhe goja iu shtrembërua në të majtë.

Ajo vështroi nga unë, pastaj nga shofer vëngëroshi, dhe në mëdyshje, kapi dorezën e makinës.

I kisha buzëqeshur vajzës pa të keq!. Kushedi se si më ishin ndritur sytë atij çasti. Dhe ajo kishte hipur në sedijen e pasme të makinës si ato kecat e vegjël, që pasi mendohen gjatë në buzën e kanalit, kërcëjnë pupthi sapo shohin shoqen e vet që është hedhur përmatanë!

Për të isha bërë unë dorëzënë!

Kur hyri brenda i thashë unë shoferit; -S' ka gjë more bir se zbres tek kthesa unë, pse do mundohesh...

-Si e ke emrin?

Lëvizi në sendilje dhe tha;

-Ina!

-Edhe unë nga këto fshatra jam. Komshinj jemi! Studente?

-Po. Për anglisht, në Korçë,- dhe e zgjati 'ë'-në fundore siç bëjmë zakonisht ne të zonës tonë!

-Ah kam plot miq. Se edhe unë jap mësim në universitet...Në Elbasan. Po bëj 15 vite! Jap në gazetari.

Nuk pushoja së foluri. Shofer vëngëroshi, vështronte vajzën nga pasqyra e mesit.

Makina ngrinte anash rrugës llohen e dëborës dhe linte një zhurmë të mbytur, pas saj. Nga xhami i hapur i shoferit, që ndoshta ishte në një moshë me studenten, hynte thëllimi dhe vajza, ndoshta prandaj la mesin dhe u fsheh pas sendiljes time.

Kisha qejf të bëhesha llafazan në atë kabinë, deri sa të vinte çasti të zbrisja në xhade dhe e pyeta:

-E kujt je, nga Menkulas! Se një moshë duhet të jem me babain tënd.

- E Myrto Lukut, por nuk e besoj ta njihni...ka punuar tërë jetën në minierë. Përmenda një emër dhe ajo tha.

-Kushëri e kemi! Doja t'i tregoja ndonjë histori nga jeta ime kur isha në moshën e saj dhe bridhja Devollit.

-Kam dashur një çupë kur isha në shkollë si ju! Nga fshati juaj...Ka tridhjetë vite që atëherë...Nuk di ku jeton tani...Rei e kishte emrin. U ktheva i tëri nga ajo.

Vajza ngriti supat dhe përveshi buzët. Kishte ca sytë mëdhenj të bukur dhe flokët mbi ballë i kishin krijuar një strehëzë si ato të beretave franceze ngjyrë kafe. Ballin e



kishte të gjerë dhe në anën e majtë, mbi buzë kishte një nishan të zi. Në vijë me të, deri tek cepi i syrit kishte dhe dy të tjerë; një mbi mollëzën e faqes dhe tjetrin më të madh tek bishti i syrit. Vetullat e zeza i të holla i shkonin deri afër tëmthave. Kur i hidhte flokët pas kokë, shkundeshin pikla uji që më binin mbi fytyrë. Ishte e re. E bukur. Kishte një buzagaz jo për të gjithë, se kur foli shoferi; "Shkollat e leshit!" - u ngrys në fytyrë dhe heshti.

Kur kishte folur, shoferit me emrin Meti, iu shtrembërua syri dhe buza në të majtë dhe iu duken dhembët e verdha në cep! Mudohej ta shihte në pasqyrën e mesit vajzën me flokët kapelon, por ajo ishte strukur pas meje dhe frynte bajluket, me buzën e poshtme si një bezdisje.

Picërrova sytë. Se si mu duk ai njeri!

Dikur kishin sjellë në fshat një ujk që çobanet kishin vlarë në Morave. E kishin tërhequr zvarrë nëpër dëborën e ngrirë deri në sheshin e shkollës. Ne fëmijët kishim rendur ta shihnim. Njërin buzë e kishte të përveshur dhe i dukeshin dhembët e frikshëm. Syrin e majtë ja kishin ngrënë qentë dhe, edhe i ngordhur ngërdheshej me kërcënim...

Kërkova sytë e vajzës, që quhej Ina, pas meje.

Makina kishte hyrë në pyllin e Dumbravës dhe brenda kabinës ishte bërë gati errësirë. Pylli i mëshateknave shushurinte nëpër degëzat e zhveshura. Kaçubat ndanë udhës, shkundnin dëborën dhe degëzat e përkulura deri atij çasti, lëshoheshin përpjetë në liri dhe dridheshin një copë herë nga cikna e ftohtë.

Pas dy kthesash do dukej tabela e fshatit tim, dhe nga aty, një vrap pele e kisha...

Me zor prisja të zbrisja.

"E ç'të shkoj deri në Menkulas dhe të kthehem mbrapsht?! Lëviza sërish dhe sendilja kuisi me ankim. Makina u lëshua në tatëpjetën e fundi. U duk që tej tabela "Ziçisht" me shigjetën e kaltër drejtuar nga udhëza. Deri sa të venim në Menkulas, unë kisha mbërritur në shtëpi..!

Djalosh shoferi, frenoi në anë të xhadesë dhe unë hapa derën.

U ktheva nga vajza për ta përshëndetur për herë të fundit dhe...Sytë e bukur i ishin zmadhuar. Koka i ishte mbështetur pas në ndenjësë. Shtrengoi çantën mbi gjoks dhe tha me zë të mekur...

-Po, ju sikur do vinit deri në Menkulas dhe pastaj... Fjalët mi tha si kisha dalë nga kabina dhe po paguaja...

-Po, ja! Mblodha supet dhe nuk dita ç'të them.

-Epo çdo bënë varavinga, -tha me zë të trashur djalosh shoferi dhe ktheu kokën nga udha. -Ja ku është. Arriti!

Nuk ja pashë as syrin vëngërosh dhe as buzën e shtrembër... Mugëtira jashtë ishte shtruar deri në këmbë të malit dhe mbi luginën e lumit të Devollit ishte davaritur një mjegull e dendur. Këngëzonin proskat nën dëborë. Zogjtë që kërkonin strehë më fluturuan mbi kokë.

Hapi derën e pasagjerit dhe tha:

-Hajde përpara!

-Joo! Tha Ina dhe u shtrug edhe më shumë në ndenjese duke ngjeshur çantën e librave mbi gjoks, sikur të donte ta mbulonte dhe mbronte nga ndonjë e keqe!

-Si të duash! E mbylli me forcë. Unë mbeta në udhë. Nga xhami i pasmë, në atë gjysmë terr, pashë sytë e zinj të vajzës që kishin marrë një llahtarë që ia bënte edhe më të bukur. Flokët i hodhi në anë dhe më ndoqi me sy.

Ngrita dorën përshëndetëse në gjysmë dhe e lëshova tej poshtë si të ma kishin prerë me sëpate. Nuk lëviza nga vendi. Makina shkante me zigzage nëpër udhën e dëborës.

Përpara se çobanët ta kishin vlarë ujkun vëngërosh atyre moteve, na kishte rrëmbyer dhe neve qengjin motak, Syskën në plevicën në të hyrë të fshatit.

E kishte mbytur dhe e kishte lënë pas portës në dëborë. Nëna nuk donte të na linte ta shihnim.

-Ehh. Ç'ta shohin fëmijët.. Do t'u mbetet mendja atje...! Qanim. E kishin kullotur dhe shëndoshur tërë beharit dhe vjeshtës nëpër mezhdarë ndanë lumit!

Babai nuk fliste. Shfrynte. Mblidhte zorrët e Syskës dhe pastronte kashtën e gjakosur...

-Më i dhjefsha temën! Më të mirat zgjedh o muti! Hë pse nuk rrëmbeu atë kërmën, dhinë e vjetër, por çau Syskën! Nuk kuptoj me kë e kishte inatin me ujkun vëngërosh apo me Dhinë e vjetër që gërzitë degët e thata të dushkut në grazhd?!
Mora rrugën për në fshat. Pashë dhe njëherë për herë të fundit nga xhadeja ku troshitej makina e djalosh shoferit, në atë mugëtirë të natës së kërsëndellave dhe eca kuturu. Ngrita kokën nga qielli i vrenjtur. Më digjnin tëmthat. Flokët e dëborës më ranë mbi fytyrë dhe ndenja plot çaste ashtu drejtuar nga qielli.

"Do ta mbysë, thua?!" Thashë nëpër natën që po mbulonte dhenë.. Kur u duken dritat e fshatit ende nuk vija dot në vete. Më ishte tharë pështyma në fyt. Mora dëborë dhe e futa në gojë. Dëborë e ftohte dhe pa shije.

"Do ta çajë!" Isha gati të qaja si dikur për Syskën tonë, që pat mbytur ujkun vëngërosh me sy dhe buzë të copëtuar nga qentë..

xxx

Sa herë marr udhën e fshati në prag të dimrit me dëborë më kujtohet ajo ditë e largët e kërsëndellave dhe kam një peng të madh me veten; Nuk di ç'u bë me atë studenten e anglishtes me emrin Ina në atë dimër të largët...dhe tëmthat më skuqen, më nxehen njëlloj si atë ditë në kur bota festonte kërsëndellat.

Legata e Shqipërisë¹

Athinë, më 21 janar 1924

Nr. 89

Shkurtim: Mbi pjekjen me z. Venizelo²

Zoti Ministër,³

Do të keni marrë dy copat e gazetës royaliste "Xëpa" 16 dhe 17 ct., ku është botuar një pjekja ime e imarhinuar me Venizelon dhe përgënjeshkrimi që dhashë unë.

Mbrëmjen e 17 ct, poqa për herën e parë z. Venizelo në një soiree në Legatë të Francës.

Pardje i kërkova një pjekje dhe më caktoi për sot 12.10 më drekë.

Ibëra urimet e mia dhe i rrëfeva shpresën që ardhja e tij në fuqi do të lithnjë edhe një herë marrëdhëniet e mira të filluara midis dy shteteve.

Do të përpiqem të raportoj përgjigjen e tij.

- Munt të jini sigur se ne mua do të gjeni njerin më të konviktuar për kolaborim të mirë midis Greqisë dhe Shqipërisë. Qeshë i shtrënguar të mbronj interesat e Greqisë, bëra detyrën time, si edhe ju bëtë tuajën. E shoh që kishit të drejtë. Teza juaj që më e vërteta dhe unë përulëm para jush. Puna e kufinjve u nda. Tani të kemi marrëdhënie miqësore, regata ekonomike. Dhe me qenë se kemi që të dy palët do elementë grekë dhe shqiptarë në kufit tona, të përpiqemi t'u sigurojmë të drejtat sipas parimeve të njerëzisë dhe të engazhementave të minoritetëve.

Në fjalët e tij z. Venizelo foli dhe për afërinë midis dy racave, për kolaborimin⁴ historik dhe më kujtoi se një herë në qeveri të tij kishte pasur pesë ministra shqiptarë: Repulis, Míaulis, Kunduriotis, Danglis edhe s'e di kë tjetër.

Fjala, duke ardhur në relatat e mira midis dy shteteve, i thashë se jemi si dy vëllezër që janë zënë për trashëgimin gjersa ta ndajnë: po tani që trashëgimi u nda dhe nuk gjendet ndonjë shkak për zihje, duhet kolaborim dhe shkuarje të mirë.

Edhe fjalën e solla në nevojën e çështjes të shqiptarëve myslimanë (shkëmbimit - red).

Këtu Venizelua sikur u mërzi pakë.

- Unë në Lausanne, tha, dhashë fjalën për këtë punë. Po s'e dinja që është kaq e komplikuar. Pardje mësova se duhet të dimë më parë se cilët janë shqiptarët?

Bisedimi mbajti afro ½ orë. I dhashë

1 Arkivi Historik i Ministrisë së Jashtme, Dosja 79, viti 1924. Dorëshkrim (red).

2 Venizelos, kryeministër i Greqisë (red)

3 Pandeli Evangjeli (red)

4 Bashkëpunim (red)

NJË LETËR E PAZAKONTË E MID'HAT FRASHËRIT

Nga Uran Butka

Në letrën që Mid'hat Frashëri i dërgonte ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Pandeli Evangjelit, më 21 janar 1924, lexuesi do të gjejë përpjekjen e diplomatit të shquar shqiptar Frashëri, ambasador i Shqipërisë në Greqi (1923-1926) për normalizimin e marrëdhënieve me shtetin grek, si edhe për ndalimin të shkëmbimit e paligjshëm të popullsisë myslimane shqiptare (çame dhe jo çame) të Greqisë me kolonë (refugjatë) grekë të ardhur nga Turqia, shpronësimin e grabitjen e pasurive të tyre të tundshme e të patundshme të shqiptarëve dhe largimin me dhunë policore apo me mashtrim nga trojet e tyre për në Turqi.

Për ta parandaluar këtë shkëmbim tragjik të shqiptarëve, në shkelje flagrante edhe të traktatit të Lozanës mes Greqisë dhe Turqisë për shkëmbin të popullsisë mes tyre, i cili i përjashtonte shqiptarët (firmosur në Lozanë edhe nga Venizelos), Mid'hati vepron fuqimisht pranë çdo qeverie greke, u dërgon nota, shpjegime, kritika dhe bën takime me gjithë politikanet dhe kryeministrat e Greqisë, mban lidhje, mban ligjëratat e protesta në kancelaritë evropiane dhe në Lidhjen e Kombeve, kritikon qeveritë shqiptare për një reagim të pamjaftueshëm, deri sa arrin me në fund ta ndalojë shkëmbimin, që s'ishte tjetër veçse një spastrim etnik, pas mijëra e mijëra shpërnguljeve të shqiptareve nga Çamëria dhe Kosturi, Follorina, Konica etj.

Në këtë përpjekje bën pjesë edhe takimi e biseda me kryeministrin Venizelos në fillim të vitit 1924, me të cilin kishte pasur përballje në mbrojtje të vazhdueshme të çështjes shqiptare në Greqi dhe në Konferencën e Ambasadorëve në Paris dhe në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, sidomos për kufijtë, për pretendimet e politikës greke mbi të ashtuquajturin Vorio Epir, kryesisht për Korçën, Gjirokastrën e Himarën, si edhe për njohjen e te drejtave të munguara të shqiptarëve në Greqi, për jetën, pronën, gjuhën, shkollimin, dokumentacionin e munguar, votën, fenë etj.

Në bisedën me kryeministrin grek, Venizelosi pranon me sinjeritet xhentëlmenësh: "Qeshë i shtrënguar të mbroj interesat e Greqisë, bëra detyrën time, si edhe ju bëtë tuajën. E shoh që kishit të drejtë. Teza juaj ishte më e vërteta dhe unë përulëm para jush".

Ai dhe Mid'hati dakortësojnë tashmë për marrëdhënie miqësore dhe ekonomike të ndërsjellëta, për bashkëpunim. Kjo është e rëndësishme. Por kur vjen puna tek thembra e Akilit, të shkëmbimit të popullsisë greko-turke, ku politika greke ka përfshirë enkas edhe shqiptarët, Venizelo vihet në siklet dhe e largon problemin nga vetja.

Diplomati ynë i bën mjeshtërisht portretin politikantit Venizelo:

"Me gjithë fjalët e ëmbla, me gjithë buzëqeshjet dhe sigurimet e tij, unë dola nga kjo pjekje me konviktimin se Venizelua ka vendosur të mohojë angazhementet që ka marrë dhe se do të kërkojë me çdo mënyrë që të shpëtojë prej shqiptarëve, duke i përzënë dhe duke i grabitur pasuninë.

Insistova që të dëgjonj nga goja e tij ç'kupton prej fjalës shqiptar. Vetëm një gjë mora vesh: insistimi im e mërziiste... Më duket se z. Venizelo nuk do të jetë më pak grek se grekët e tjerë".

shpjegime. Po Venizelua u pendua që hyri në diskurcion; dhe iu retranhuua prapë kësaj përgjigjeje: "Do kuvenduar me Ministrin e Punëve të Jashtme, ne qenë se ay është kompetent, po nga ana ime munt të jini sigur se do të rrëfejme dispozitat më të mira dhe më miqësore".

I hapa çështjen e teqeve bektashi në Greqi; kuvënduam, po edhe për atë refuzoi

të më japë një përgjigje, duke e lënë që do biseduar me Ministrin e Punëve të Jashtme.

Këtu mbyllur po të dërgonj komunikatën zyrtare, që u dha prej kryeministrisë për pjekjen time.

Me gjithë fjalët e ëmbla të kësaj komunikate, me gjithë buzëqeshjet dhe sigurimet e tij, unë dola nga kjo pjekje me konviktimin se Venizelua ka vendosur të mohojë angazhementet që ka marrë dhe se do të kërkojë me çdo mënyrë që të shpëtojë prej shqiptarëve, duke i përzënë dhe duke i grabitur pasuninë.

Insistova që të dëgjonj nga goja e tij ç'kupton prej fjalës shqiptar. Vetëm një gjë mora vesh: insistimi im e mërziiste.

Me Ministrin e Punëve të Jashtme z. Roussos, pasnesër 23 ct., kam pjekje.

Një ditë në fjalë e sipër me z. de Marcilly, Ministri i Francës, më tha këto fjalë: Grekët e dinë mirë cilët janë turq dhe cilët janë shqiptarë. Po duan që të grabitin pasuninë e shqiptarëve. Pandaj duan edhe t'i përzënë.

Më duket se z. Venizelo nuk do të jetë më pak grek se grekët e tjerë.

Pritni, ju lutem, Zoti Ministër, të falat e mija me nderime.

Mid'hat Frashëri

Shkëlqesës së Tij
Zotit Ministër të Punëve të Jashtme
Tiranë



Ai hapi perden e hollë të dritares dhe hodhi vështrimin jashtë. Gjithçka kishte marrë një ngjyrë gri të hapur. Qielli i veshur me një shtresë të njëtrajtshme resh, shiu që binte i qetë, drurët e zhveshur të rrapeve në rrugën përballë, tingujt e një pianoje që dukej sikur buronin nga ajo masë gri dimërore, i ndillnin një përgjume të ëmbël. Ai ndjeu se ajo nanurisë po e mbështillte ngadalë me mantelin e hollë gri... në fillim kokën, pastaj krahët, grupin, gjymtyrët... Gjithçka... I përhumbur u shtri në divan pranë dritares. Tingujt e pianos, ata tingujt të largët, tepër të largët, (dhe ai mendoi se ndoshta kjo shkakohej nga përgjumja ose ndoshta nga ajo masë gri, që zotëronte jashtë), i vinin qartë në vesh e shiu binte qetë-qetë, si të kishte vite që kishte nisur. Ashtu i përhumbur ai mendoi për telegramet që do t'u niste të afërme në qytetin e largët, për lajmërimet që duheshin bërë sa më shpejt. Duhet shkruar bukur, mendoi. Me bojë të zeze. Me rastin e përvjetorit... Kujdes. Po. Përvjetorit... Tani me shkronja kapitale TË NENËS TONË TË DASHUR. DA-SH-U-R. Ashtu... Mirë. Lëre të thahet pak... Kryeradhë... Presim vizita nga ora... Ta shkruajmë me të kuqe orën... Duhet të duket ora. Bukur. 18. Adresa. Me blu adresën. Nuk keni blu? Përzieri të verdhën me të gjelbrën. Do të dalë blu... Provoje... Kjo është gri... Nuk shkon adresa me gri... E po mirë, shkruaje... Adresë gri. Pajtim Kulla... Lagjja 2, Blloku 25, rruga... pallati 8, apartamenti 12... Lëre të thahet... Shumë mirë ka dalë. Vetëm adresa... Duhet bërë edhe katër copë të tjera. Do t'i vendos në disa vende... Në stacionin e trenit... Krejt gri. Gri e hapur. Një në stacionin e autobusëve... Një në dyqanin ushqimor. Gri e mbyllur. Më mirë gri e mbyllur... Një në dyqanin e bukës. Në një vend të dukshëm... Sot është e shtunë, mendoi ai. Pas saj do të vinte e diela. Pas saj e hëna dhe ditët e tjera. Të gjitha duhen bërë. Pas një jave duhet të jetë gjithçka gati. Gjithçka. Të dielën gjithë ditën do të pritnin e përcillnin njerëz. Ndoshta xhaxhai dhe tezja nga qyteti i largët do të vinin që të shtunën në darkë. Do të vinte e hëna. E pas saj ditët e tjera. Sidoqoftë të hënën duhet biseduar me Nikon për shkrimin e lajmërimeve. Të martën ato duhen marrë e vendosur. Edhe telegramet duhen nisur sa më shpejt. Pastaj kafja... Ah, dhe fotografia e madhe. Të gjitha këto ai i mendoi mes asaj përgjumjeje... E më pas nuk ndjeu as tingujt e pianos e as të shoqen që u kthye nga puna... Ndiende vetëm se ecte ngadalë, mes një humbëture gri resh... Vrapoi në brigjet e lagura të një deti... E në ëndërr pa, për një kohë të gjatë, vrapime... Ishin ca vrapime të gjata drejt diçkaje që dukej e zhdukej. E thërriste të ndalej, por ajo zhdukej e ai vraponte e vraponte pas atij zëri që i kujtonte nënën. Me këtë ndjesi u ngrit rreth orës 7. Nga kuzhina vinte zhurma e ujit të çezmës dhe zëri i spikerit të televizionit. Jashtë dritat e dobëta çanin errësirën e shiut vazhdonte të binte. Trupin e ndiente të lehtë. Përgjumja sikur i kishte fluturuar jashtë e, i çliruar prej saj, mendoi për një çast të hënën... Pastaj zërin e nënës, që e kishte dëgjuar në ëndërr, dhe ndjeu një shije të hidhur në gojë.

E hëna

Ata blenë kafën. Pastaj e poqën atë dhe e vendosën në raftin e parë të bufesës. Në orën gjashtë pasdite filluan bluarjen e saj. Dhe në mbrëmje vonë, kur e bluan, e shoqja tha se i dukej pak kafe.

- Të kishim marrë edhe dy pako, - tha ajo.
- Mjaftojnë, - ia ktheu ai. - Ishin pesë pako.
- Ndoshta nuk dalin. Më mirë të jetë më tepër.
- Do të marr nesër edhe dy pako.
- Merr më shumë. Mos turpërohemi, - tha ajo.
- Nuk turpërohemi, - tha ai. - Kot

SHTATË DITË (ME TË DIELËN)

Tregim nga Enver Kushi



shqetësosh.

- Mos turpërohemi, - këmbënguli e shoqja. - Do të na vijnë shumë njerëz.
- Mirë, - tha ai, - do të marr katër pako.

E marta

Në mëngjes ata u ngritën herët. Ai u ankua se kishte fjetur keq e se kishte parë shumë ëndrra.

- Kokën e kam të rëndë, - tha ai.
- Po bëj një kafe, - nxitoi ajo.
- Lëre kafën. Mos e prek atë kafe.
- Do të të bëj një kafe të fortë, - tha ajo duke vënë xhezven në prizë.

Kafja u bë shpejt. Duke pirë, ai mendoi se duheshin marrë lajmërimet te Nikoja. Duhet vendosur jo më vonë se të nesërmen. Për telegramet është shpejt, mendoi.

- Po fotografinë? - pyeti ajo.
- Nuk e ka bërë, - mblodhi buzët ai.
- Do të ketë dalë bukur?
- Besoj se po, - tha ai.
- Them ta vendosim ja këtu në ballë.
- Mirë. - Ai u ngrit. - Të shohim kur ta marrim. Ç'bërë për filxhanët?
- Do t'i them Tixhes.
- Të paktën të jenë 24 filxhanë.
- Dymbëdhjetë do t'i marr te Tixhja, - tha ajo.

- Mos janë pak, - u interesua ai duke veshur pardesynë.

- Fotografinë do ta vendosim, ja këtu, - tha ajo dhe preku me dorë murin. - Do të jetë një surprizë.

Ata dolën me nxitim nga shtëpia. Jashtë binte një shi i hollë. Në rrugë kishte lëvizje. Në stacionin e autobusit, pa rrapin ku qe vendosur tabela e njohur e qëndrimit. Ai mendoi se njëri nga lajmërimet duhej vendosur atje. Është një vend ku lëvizin shumë njerëz, tha me vete. Ai u afrua pranë rrapit, mati me sy largësinë e tabelës nga toka dhe mendoi vendin e mundshëm ku do

të vinte lajmërimin. Rreth orës tre pasdite, në vendin e caktuar, ai vendosi përkujtimoren. Vend i mirë, mendoi me kënaqësi, dhe u largua duke kthyer kokën pas për të parë atë lajmërimin, shkruar aq me kujdes nga shoku i tij piktor. Pas dy orësh u kthye përsëri në të njëjtin vend. Lajmërimet e tjera i kishte vënë në vendet e caktuara. Një në Pazarin e Ri, në vendin e zakonshëm, ku viheshin lajmërimet e vdekjeve dhe përkujtimoret. Dy në qendër, në një vend të dukshëm. Një në shtyllën e betonit, që ndodhet sapo kalon rrugën e Unazës, në të hyrë të rrugicës që të çon në stacionin e trenit. Sidoqoftë ky është vendi më i mirë, mendoi duke vështruar lajmërimin shkruar me ato shkronja të mëdha kapitale. Ishte shkruar me të vërtetë bukur. Emri i nënës, Data; Adresa me atë grinë e mbyllur. Emri i tij dhe i Ritës: Krejt gri: Një gri e ëmbël, që kontrastonte me të zezen. Nën ndriçimin e dritës së bardhë të neonit ajo gri e emrave të tyre dukej e zbehtë. Blu do të ishte më bukur, tha ai me vete, duke u larguar. Vetëm shi i fortë të mos bjerë, shtoi. Atë ngjyrë gri shiu sikur e shpëlan. Ktheu edhe një herë kokën. Neoni ndriçonte trungun e rrapit.

E mërkuara

Dita nisi me një shi të rrëmbyer dhe me re. Ai u vesh shpejt, piu gotën e qumështit dhe vrapoi në rrugë. Do t'i ketë marrë era, mendoi për lajmërimet. U qetësua kur vuri re që lajmërimi në stacionin e autobusit nuk kishte pësuar gjë. Pikat e mëdha të shiut binin mbi të. Vetëm gria ishte zbehur. Emri i tij. I Ritës. Ishte një çngjyrosje e lehtë. Këtë e vuri re edhe në lajmërimet e tjera. Gri e hapët. Emra gri të hapët. Ky shi i mallkuar, mendoi. Ku e gjeti të bjerë me kaq rrëmbim.

Rreth orës 14 Rita ngjiti me nxitim shkallët. U ul në karrige vetëm pak çaste, sa për të mbledhur veten. Tërë pasditen u mor me sistemimin e kuzhinës. Ndryshoi disa

herë vendin e shqiponjës e të kaktusit dhe fshiu me kujdes të gjitha qoshet e dhomës së gjumit. Në mbrëmje e ndiente veten të lodhur. Gjumi e zuri shpejt.

E enjtja

Telegramet i shkroi rreth orës 15. Tekstet ishin të njëjta. Ditën e diel, me rastin e përvjetorit të vdekjes së nënës sonë të dashur... Në fund emrat e tyre të shkruar me majën e hollë të penës që gërricte. E lexoi edhe një herë. Ditën e diel... Bukur, mendoi duke ia zgjatur punonjëses së shërbimit. Seku e kishte parë atë fytyrë. Ndoshta në rrugë. Ndoshta ishte ajo e para disa viteve, kur nga kjo postë i kishte nisur telegram vëllait të vogël në qytetin e largët. Atëherë ishte e shtunë kur kishte shkruar atë telegram me një tekst të shkurtër: "Eja menjëherë." Dhe vëllai i vogël erdhi të nesërmen me trenin e fundit.

- Ç'ka ndodhur? - pyeti ai, i shqetësuar, sapo hyri brenda. - Si është nëna?

- Asgjë. Mirë është, - u përgjigj ai. - Ja ashtu. U mërzit ca dhe... dërguam telegram.

Vëllai i vogël kishte shtangur. Nga flokët e qullur nga shiu i dilte avull. Hyri në dhomë, përqafoi nënën, i puthi asaj duart. Nëna përloje.

- Të ishte ditë, do të merrja një taksi e do të ikja, - tha ai. - Do të ikja sa më shpejt me nënën. Se ti... Edhe ti, - iu drejtua Ritës. - Ju... Ti...

Iu mor goja vëllait të vogël. Kështu i ndodhte sa herë që nervozohesh.

- E pra, ju... Ti... Për këtë e doni nënën? Që të fitonit edhe një dhomë tjetër kur morët apartament të ri? Ju... Ti...

E nëna iku të nesërmen me vëllanë e vogël. Ishte prill e nëna kishte qarë.

"Pajtim, o djalë, tha nëna. Të vini nga ne. Merr nusen dhe ejan." E pas një viti rrëzimi i vëllait të vogël me makinë, vdekja e tij sapo kish mbërritur në spital dhe... Të gjitha këto ndodhën aq shpejt, mendoi ai duke dalë nga posta. Shiu kishte pushuar, po përsëri mbetej gria e qiellit, një gri e mbyllur. Duhet marrë fotografia, mendoi. Kaloj qendrën dhe gati sa nuk u përplas me një biçikletë. Hipi në trotuar. Seç kishte një përhumbje... Kjo gri e mallkuar... Të pres në mbrëmje... Para kinemasë... Kur të duash... Emrin, ju lutem. Keni dalë vetëm? Aha, nëna. Faturën. Fotografia ishte e bukur. Me ngjyra. U ul në njërin nga karriget dhe e vështroi për një kohë të gjatë atë fotografi. Sytë e butë të nënës... Buzëqeshja e lehtë në fytyrën me rrudha... Shalli i zi hedhur supeve dhe flokët e thinjur. Ai ndjeu një drithërim të lehtë. Si nisi ajo grindje, mendoi. Kujtoi atë natë kur ai i dha të drejtë Ritës.

Të kam djalë të vetëm, o bir, tha nëna. Të dua si dritën e diellit. Edhe nusen e dua. Si dritën ju dua. Pastaj ftohja e Ritës me nënën. Pastaj heshtja e gjatë e nënës... Pastaj nervozizmi i vazhdueshëm i Ritës... Ardhja e dajave nga qyteti i largët. Lotët e nënës... Pastaj në këshillin e lagjes dhe pëshpëritjet në pallat... Si ndodhi kështu, tha ai duke e mbështjellë fotografinë me një letër të madhe.

E premtja

Në të dhënat e shërbimit sinoptik të orës 20,30 u fol për një presion të lartë që do të përfshinte territorin e vendit në 24 orët e ardhshme. Në vendet malore do të kishte mjegull deri në orët e mesditës. Në zonat e ulëta vranësira të ndërrueshme, e në bregdet kthjellime.

Ai mori frymë i lehtësuar kur ai që jepte parashikimin e kohës buzëqeshi e tha "natën e mirë". Domethënë kohë e mirë, tha ngadalë. Të paktën këto dy ditë. Sidoqoftë edhe koha... Në një ditë me shi... Telegramet do të kenë arritur në qytetin e largët, mendoi. Do të vijë

tetoja, xhaxhai, dajat me djemtë e mëdhenj...

Ca pika shiu trokitën në dritare. Të rralla, sikur vinin nga re të largëta që iknin e, para se të ndaheshin, lëshonin, në udhë e sipër, ato pika lamtumirë...

- E mrekullueshme, - tha Rita duke u ulur pranë tij. - Do të jetë një surprizë.

- E ka punuar mirë, - tha ai mendueshëm. - Është një fotografi shumë e bukur.

Ai hodhi vështrimin në atë fotografi. Sytë e nënës sesi vështronin...

Trokitën prapë pikat e shiut në dritare... Një... Dy... Tri, numëroi ai. Retë e fundit iknin të shtyra kushedi nga ç'erëra për t'ia lënë vendin qiellit të pastër të yjeve. Natën e mirë.

E shtuna

Në orën 12 Rita solli një tufë të madhe me lule. Ishin lule të freskëta. "Deri nesër nuk ka pse të vyshken", mendoi. Do ta ruanin freskinë kur të shkonin në varrin e nënës. Në ballkon i spërkati me ujë. Qëndroi për pak çaste para pasqyrës së tualetit. "Përse e kam këtë zbehtësi kështu", tha me vete duke parë fytyrën. Sytë i kishin hedhur një rreth mavi... Gjithë këto ditë me punë... Lodhja... Gjumi... Megjithatë gjithçka ishte gati. Kafja e bluar. Filxhanët e larë e të vendosur në bufe, tabakatë e bukura prej bakri, sheqeri, tri xhezve të mëdha, kanat për ujë dhe gotat, pecetat e bardha të qëndisura me gjethe dhe vile rrushi... Kostumi kafe i pastruar... Gjithçka. Në mbrëmje do të shtronte qilimin e ri.

Kështu kaloi paraditja. Pasdite pastroi edhe një herë bufenë, shtroi qilimin dhe i ndryshoi vendin lule shqiponjës. Ishte mbrëmje vonë, kur ai i tha se kishte frikë se mos prishej koha.

- Na duhen karrige, - tha ajo. - Do t'i gjejmë. Nesër në mëngjes do t'i gjejmë. Vendi është i ngushtë, - shtoi ai. - E shumta mund të marrë pesë karrige.

"Vetëm të jetë kohë e mirë", mendoi ai. I shtrirë, u përpoq të shihte një pjesë të qiellit që dukej nga xhami i dritares. Nuk pa asgjë, veç një mase të zezë që shtrihej në pafundësi. Ndoshta ishin retë, që iknin të shtyra nga era.

Le të iknin për t'u përplasur në maja malesh e ta derdhnin dufin e tyre kushedi se në ç'qytete e fshatra të largëta. Le të iknin... E në atë përgjumje të lehtë i vinin fjalët e shpjeguesit të shërbimit sinoptik... Do të jetë kohë e mirë, me vranësira të ndërueshme e me ndonjë shi të dobët lokal... Natën e mirë...

E diela

Zgjimi u bë më shpejt se ditët e tjera dhe kafja u pi në këmbë, me një ngutje të çuditshme. Pas kafes hëngrën pak bukë me gjalpë. Pas bukës me gjalpë pinë nga një gotë me qumësht të nxehtë. Edhe këto në këmbë.

Ora ishte shtatë kur ajo shkoi në dhomën e gjumit për të veshur kostumin e ri. U pa disa herë në pasqyrë dhe me kënaqësi mendoi se i rrinte shumë mirë. Ai kostum i nxirrte më në dukje zbehtësinë e fytyrës, rrathët mavi të syve...

Në orën tetë ajo i tha se dera duhej lënë hapur, se njerëzit që do të vinin, nuk kishte pse t'i binin ziles, se në raste të tilla...

- Nuk ka pse ta lëmë hapur, - tha ai.

- Atëherë po hap pak dritaren, - tha ajo. Nga jashtë hynë në dhomë zërat e zakonshëm të mëngjesit. Ngado ndihej e diela: në boritë e zgjatura të makinave, zërat e fëmijëve, këngët e radiove (çuditërisht volumi u qe ngritur deri në fund). Ai shihte herë pas here orën, fushën e saj të bardhë dhe lëvizjen e akrepit të sekondave, që ishte tepër e shpejtë, tepër e ngutshme dhe në kundërshtim me qetësinë gati moskokëçarëse e dy të tjerëve. E diela, mendoi ai. Edhe në këtë fushë të bardhë ore e në ngutjen e sekondematësit. Në orën dhjetë u dëgjua hapa që ngjtinin shkallët e katit të tretë e ata u ngritën instinktivisht në

këmbë për të pritur tingullin e ziles. Po hapat vazhduan të ngjiteshin më lart. Zotëroi një heshtje e gjatë. Vetëm zërat e së dielës dëgjoreshin që vinin, të gjithëpushtetshëm, nga jashtë. Në orën dhjetë e tridhjetë minuta ai pyeti se kur vinte treni nga qyteti i largët.

- Nuk e di.

- Si nuk e di?

- Mos u nervozo, - tha ajo. - Nuk e di.

- Duhet ta dish!

- Mos u nervozo, - përsëriti ajo. - Ç'jam unë, të mbaj mend të gjitha oraret e trenave?

- Nuk të kërkova oraret e gjithë trenave, - tha ai.

U dëgjua zilja dhe ajo vrapoi në korridor. Pas aj Pajtimi. Rita hapi derën dhe, kur u bë gati të thoshte me mirësjellje "Urdhëroni", "Mirë se na erdhët", burri i gjatë pyeti:

- Mos e njihni Kujtim Çelën? Më falni...

- Një kat më lart, - tha ajo dhe mbylli me forcë derën.

Në orën trembëdhjetë u dëgjua përsëri hapa dhe më pas një e trokitur e lehtë. Ajo hapi derën. Ishin dy fëmijë që luanin me njëri-tjetrin.

Ora ishte katërmëdhjetë, kur ai e pyeti sërish për orarin e trenit.

- Nuk e di, - ia priti ajo. - Të thashë edhe një herë. Nuk e di.

Rreth orës gjashtëmbëdhjetë ai u ngrit, lëvizti nëpër dhomë, pa me vëmendje filxhanët të radhitur me kujdes në bufe, pecetat me gjethe e vile rrushi... Të gjitha ishin gati. E diela po thyhej e nga jashtë zërat vinin si përmes një muzgu të mpiksur. U ul në njërin nga divanët. Pa orën dhe sekondematësin e ngutur që vazhdonte të gëlltiste çastet e fundit të së dielës... Pastaj vështrroi të shoqen, fytyrën e saj të zbehtë dhe rrathët mavi poshtë syve.

- Më jep një lugë sheqer, - tha ai pas pak. Ajo e pa e habitur të shoqin.

- Kërkova një lugë sheqer, - foli prapë ai. Ajo përsëri nuk lëvizti. Atëherë ai iu shkreh:

- Ç'rri ashtu si mumje, të kërkova një lugë sheqer! Më kupton? Kërkova një lugë sheqer. She-qer. Shqip e thashë. Sheqer!

- Po ti...

- Sheqer...

Ajo u ngrit e shtangur nga ai shpërthim i papritur i të shoqit dhe nga ajo kërkesë e çuditshme e tij. Hapi menjëherë bufenë, mbushi lugën dhe ia zgjati.

Ai u ngrit dhe në këmbë nisi të përtypte kokrrat e sheqerit. Pastaj u ul në divan duke vazhduar të përtypej.

- Këtë kërkova, - tha ai. - E kisha gojën helm.

U shtri. Zërat e së dielës vinin të mbytur. Trokitën ca pika të rralla shiu në dritare dhe më pas u dëgjua tingujt e pianos. Të largët, tepër të largët iu dukën ata tinguj, sikur zbritën bashkë me pika të shiut nga lartësitë e reve gri... Afroi dorën e majtë pranë veshit e dëgjoji tiktakun e shpejtë të sekondematësit. Ditët do të vazhdojnë të vijnë përsëri pas kësaj së diele, mendoi. Do të vinte e hëna, e marta, e mërkura, e enjtja, e premjtja, e shtuna... E prapë e diela. Me ngutjen e sekondematësit... Vetëm ajo nuk do të vinte më, sado lajmërim apo telegrame të bënte... Në asnjë përvjetor. Në asnjë të diel. Ndjeu prapë një shije të hidhur në gojë dhe një vetmi rrëqethëse. U ngrit përgjysmë dhe hodhi shikimin mbi fotografinë në mur... Sytë e nënës... Të butë, me atë vështrim të dhembshur nënë... Dhe ra përmbyb në divan e qau.

Ishte fundi i ditës së diel, me ca pika të rralla shiu që trokitën në dritaren e apartamentit nr. 12.

Shënim:
Ky tregim është botuar në gazetën "Drita" pas mesit të viteve "80, kur kryeredaktor ishte prozatori i mirënjohur, Zija Çela. Tregimi u vlerësua me Çmimin e parë të kësaj gazete.

Një vëllim i ri, një personazh i ri dhe një autor i ri RECENSION MBI PROZËN "ANDRUSHI", TË AUTORIT MË TË RI TË LETËRSISË PËR FËMIJË FLORIKASAJ

nga Prof. Dr. Klara Kodra

Letërsia shqiptare për fëmijë po spostohet gradualisht nga roli dytësor në të cilën e ka lënë për një kohë të gjatë kritika dhe po riafirmohet me vlerat e saj ideore dhe estetike. Për më tepër, ajo po fillon të përdoret me gjak të ri.

Një autor i ri, si në moshë ashtu edhe në krijimtari, Flori Kasaj, ka nxjerrë në dritë vëllimin e tij të parë, tregimin animalistik "Andrush", në botimin e kujdesshëm që i ka bërë shtëpia botuese e mirënjohur "Argeta LMG", duke shkruar bukurinë e brendshme të mesazhit dhe formës me rrezatimin e një bukurie të jashtme, me një kopertinë tërheqëse ideuar nga autori dhe ilustruar plot gjallëri nga Endri Beqo.

Përveç parathënies, vëllimin e shoqërojnë dy vlerësimet kritike nga Dr. Natasha Shuteriqi Poroçani dhe Dr. Erion Kristo.

Kam qenë e pranishme në festën e këtij vëllimi, në mjediset e Qendrës Toptani në Tiranë, në atmosferën e gëzueshme të Panairit "Ditët e librit" të organizuar nga Bukinist.al.

Duke lënë mënjanë modestinë, kam thënë se kam një farë merite në lindjen e këtij vëllimi meqenëse e kam nxitur autorin në pasionin e tij për letërsinë dhe për krijimtarinë letrare, në çeljen e sipër, kam bërë që një shkëndijë të shndërrohet në flakë dhe e kam shoqëruar këtë vëllim me një parathënie.

Sot, më shumë se kurrë, janë të gjalla fjalët e paharrueshme të Romen Rolanit: "Ku është vdekja, arti nuk është. Të krijosh do të thotë të mbysësh vdekjen".

Në një kohë kur dhuna e shfaq fytyrën e vet të egër në luftën e Ukrainës dhe kësaj dhune i kundërvihet nga ana tjetër solidariteti njerëzor, lindja e veprave të reja artistike pohon se vazhdojnë të ekzistojnë ende e Mira dhe e Bukura, vlera të qëndrueshme që meritojnë t'i transmetohen brezit të ri si spiranca të sigurta.

Në vëllimin "Andrush", autori i ri Flori Kasaj na sjell një personazh të ri, tepër simpatik, kekrushin Andrush, një personazh që shkruar veçoritë biologjike të bukurisë dhe shkathtësisë me veçoritë etike të guximit dhe dashamirësisë. Personazhi di të luftoj për mbijetesë, që zotëron edhe tiparin e solidaritetit ndaj mikeshës së vet Andrina, me të cilin ndan ushqimet dhe lodrat.

Ky personazh ka veçoritë e veta që e dallojnë nga personazhet e tjera kafshësh të antropomorfizuara që janë bërë të njohura në letërsinë shqiptare për fëmijë

si derrkuci Çufo ose Bubi kaçurrel i autorit Gaqo Bushaka nga të cilët i pari simbolizon fëmijën e vështirë dhe Çufon po zemërmirë e të këndshëm, plot fantazi e guxim dhe i dyti një fëmijë të zellshëm dhe besnik.

Në tregimin "Andrush", elementi fantastik lihet mënjanë, personazhet, ndonëse disi të antropomorfizuara, mbeten brenda rolit të tyre real, nuk mendojnë, as nuk flasin, vetëm veprojnë.

Veprimi zhvillohet në mënyrë dinamike dhe ka të papriturat e veta, çka përputhet me psikologjinë e lexuesit të vogël. Shkathësinë dhe guximin e personazheve ketra e plotëson solidariteti njerëzor i gjyshes Vera dhe vajzës së vogël që e lënë ushqimin atyre. Ngjarjet shtellohen në sfondin e disa tablove konkrete dhe të gjalla nga natyra.

Kjo vepër e re për fëmijë, pra, e shikon me dashurinë për frymorët e tjerë me veçoritë që i dallojnë nga njerëzit dhe me ato që i afrojnë me ta, me respektin ndaj veçanësisë së tyre, brishtësisë së tyre ashtu si ndaj luftë së tyre për mbijetesë. Mesazhi jepet në mënyrë të këndshme, përmes skenave të gjalla dhe një humorit të lehtë.

PARATHËNIA E LIBRIT:


Proza "Andrush" është një tregim i shkurtër animalistik për fëmijë të vegjël i autorit më të ri Flori Kasaj. Ky tregim dallohet për thjeshtësi, koncizitet dhe dinamizëm, madje edhe për një humor të lehtë, cilësira këto, që i japin një forcë komunikuese me fëmijët të cilët e pëlqejnë rrjedhën e shpejtë të ngjarjeve dhe të papriturat. Dy personazhet kryesore, dy kafshë simpatike siç janë ketrat, janë të antropomorfizuar, po kanë edhe veçoritë e tyre biologjike.

Tregime të tilla për fëmijë janë thellësisht edukuese, ngaqë nxisin dashurinë për krijesat e gjalla, "vëllezërit e vegjël" të njeriut, i mësojnë fëmijët të vlerësojnë tiparet e frymorëve në shumëllojshmërinë e tyre, kështu që kanë njëkohësisht vlerë njohëse dhe ideo-emocionale. Interesant e i domosdoshëm për fëmijët libri i trajtuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.

Autori i ri tregon qysh në këtë tregim të vogël që e njej mirë psikologjinë e fëmijëve, kështu që mund të fitojë interesin e gjallë të tyre si lexues dhe t'u kultivojë dashurinë për librin.

I uroj autorit të ri që këtë krijesë të tij simpatike ta pasojnë personazhet e tjerë nga vëllime të reja.

10 Prill 2022



ELENA

Me pikën e parë të shiut e vrarë mbeti vera
U lagën fjalët që kishin lindur vezullime yjesh
Gjithë fjalët që Ty të kishin të vetmin përkushtim!
Për ku do t'i shtrijmë duart tona tani që koha fare
nuk na përfill
Për ku do t'i hedhim sytë tanë tani që linjat e largëta
u fundosen midis reve
Tani që u mbyllën qepallat e tua mbi visoret tona
Dhe jemi – sikut të ketë hyrë mjergulla brenda nesh-
Të vetëm krejt të vetëm rrethuar nga vegimet e tua
të vdekura.

Me ballin mbi xham përgjojmë dhimbjen e re
S' është vdekja që do të na flakë përdhe gjersa Ti rron
Gjersa ekziston gjetkë një erë të të jetojë fundekrye
Të të vesh nga afër siç të vesh nga larg shpresa jonë
Gjersa ekziston gjetkë
Një luginë e bleruar tej buzëqeshjes tënde gjer në diell
Duke i thënë tërë besim se do të ritakohemi përsëri
Jo nuk është vdekja që do t'i përballemi ne
Por një bulëz e vogël prej shiut të vjeshtës
Një ndjenjë e vagëlluar
Kundërmimi i dheut të njomë brenda shpirtrave tanë
Që sa venë dhe largohen

Dhe nëse dora jote nuk është brenda dorës sonë
Dhe nëse nuk rrjedh gjaku ynë në venat e ëndrrave
të tua
Drita në qiellin e dëlirë
Dhe muzika e padukshme brenda nesh o! udhëtare
Melankolike për gjithë ato që na mbajnë ende në botë
Është ajri i lagësht çasti i vjeshtës, ndarja
Mbështetja e hidhur e bërrylit mbi kujtimin
Që duket kur nata vjen të na ndajë nga drita
Pas dritares katrore që vështron drejt pikëllimit
Që nuk shikon asgjë
Sepse u shndrua sakaq muzikë e padukshme flakë
Në tymtar trokitje e sahatit të madh të murit
Sepse u bë sakaq poezi me vargun tjetër jehonë paralele
Me shiun lotë dhe fjalë
Fjalë jo si të tjerat dhe ato me: Ty të vetmin përkushtim.

GJUMASHJA

Përhapat zëri erës rrëqethëse, dhe ti dihat midis drurëve
Të saj të padukshme

Është e verdhë çdo faqe e gjumit tënd dhe me të lëvizur
Gishtat e tua një flakë shpërndahet

Brenda teje me ca gjurma rrëmbyer diellit. Dhe mbarë
Flladitet bota e vegimeve

Dhe e nesërmja nxjerr gjirin e saj lakuriq të shenjuar
Prej yllit të virgjër

Që ngrys vështrimin kur shkon të shterojë një copë qiell

O mos durofshë më qerpikëve

O mos lëvizësh më gëmushave të gjumit

E di cila lutje ndez gishtave vajin vigjilues portikëve të
Agullimit

Cilit zbulim të vesuar i fëshfërin përmes pritjes
Kujtimi të cilin e ka pushtuar bari

Atje ku shpreson bota. Atje ku njeriu nuk dëshiron gjë
Tjetër veç se të jetë njëri

I vetëm dhe pa asnjë Fat me vete!

EVA

Leshohesh dallgës në heshtje
Që shkretot shpirtin tim të banuar

Një korrije pranë zjarrit
Bast i erërave të natës

Poezi nga libri në proces botimi

ODISEAS ELITIS

Përktheu nga origjinali greqisht:

NIKO KACALIDHA

Një çapitje hijeje në bregun e Kimeras
Një dhomë
Dhomë njerëzish të thjeshtë
Një enigmë
Larë e nderur në syrin që magjeps

Në vështrimin tënd
A në lartësinë e diellit të tij
Gjithë jeta ime mblidhet në fjalë
Gjithë bota baltë dhe ujë
Dhe gjithë flakrat e gishtave të mi
Dhunojnë buzët e ditës
Presin kokën tënde
Në buzët e ditës

Përballë vetmisë së ëndrrës.

Fisi që këndon në prehrin e diellit

O vajzë e zemërimit të pamatë
Që del lakuriqe nga deti
Hapi portikët vezulluese të njeriut
Të kundërmojë vendi nga shëndeti
Në mijra ngyjra të buthtojë ndjenja
Të shtrijë krahët për fluturim gjerë e gjatë
Dhe të fryjë nga të gjitha anët liria.

Ndriçoje mes predikimit të erës
Bukurinë e re dhe të përjetshme
Kur dielli i orës tre të mesditës ngrihet
Plot kaltërsi duke luajtur harmonikën e Krijimit.

MARINA E SHKËMBINJVE

Ke një shije furtune në buzë-Po ku endeshe
Gjithë ditën ëndërrimit të ashpër të gurit dhe detit
Një erë shqiponjëmbajtëse i zhveshi lakuriq kodrat
Zhveshi dëshirën tënde gjer në eshtë
Dhe bebëzat e syve të tua morën stafetën e Kimerës
Duke ravijëzuar me shkumë kujtesën!
Ku është e përpjeta e njohur e shtorit të vogël
Në dheun e kuq që lodroje duke soditur tatëpjetës
Bathoret e thella të vajzave të tjera
Cepat ku mikeshat e tua linin tufat e rozmarinave

-Po ku endeshe
Gjithë natën ëndërrimit të ashpër të gurit dhe detit
Të thoshja t'i numëroje ujit të zhveshur ditët vezulluese
Shtrirë në kurriz t'i gëzoheshe agullimit të sendëve
Apo të bridhje sërish fushave të gjëra
me një tërfil drite në gjoksin tënd heroinë jambi.

Ke një shije furtune në buzë
Dhe një fuastan të kuq si gjaku
Thellë mes prarimit të verës
Dhe aromës së zymbylëve- Po ku endeshe

Duke zbritur anëdeteve, gjinje me guralecat
Ishte atje një bar i ftohtë i njelmët deti
Por një ndjenjë njerëzore përgjakej në thellësi
Dhe hapje me habi duart duke thënë emrin e tij
Duke u ngjitur butësisht kthjellinës së thellësisë
Ku vezullonte ylli yt i detit.

Dëgjo, fjala është urtësia e mbrame
Dhe koha skulptore zemërake e njerëzve
Dhe dielli qëndron nga lart përbindësh shprese
Dhe ti pranë tij shtrëngon një dashuri
Duke patur një shije të hidhur furtune në buzë.

S' ke pse llogaritë kaltëroshe gjer në palcë tjetër verë
Që të ndryshojnë rrjedhen lumenjtë
Dhe të të kthejnë prapë te ama e tyre
Që të puthësh përsëri qershi të tjerë
Apo të shkosh shaluar mistrallit.

Ngurosur shkëmbinje pa të djeshme e të nesërme
Në rreziqe shkëmbinje me krehjen e stuhisë
Do t'i lësh lamtumirën enigmës tënde.

ODË PËR SANTORININ

Dole prej rropullive të gjëmimit
Duke u rrëqethur mes reve të penduara
Gur i hidhur, i sprovuar, kryelart
Kërkove kryemjesh të diellit
Për të përballur bashkë vezullimin e frikshëm
Për t'u shtrirë në det me një kumbim kryqëzate

E zgjuar prej detit, kryelart
Ngrite një krahëror të larmë
Shkëmbi nga frymëzimi i jugës
Që të vijëzohë atje rropullitë e saj dhimbja
Që të vijëzohë atje rropullitë e saj shpresa
Me zjarr me llavë me tym
Me fjalë që afrojnë pafundësinë
Linde zërin e ditës
Ngrite lart
Eterit të trendafiltë e të gjelbër
Kambanat që u bie mendja e lartësuar
Duke himnizuar zogjtë në dritën e mesgushtit

Bri trandje dallgësh, bri brenga shkumash
Përmes falënderimeve të gjumit
Kur nata ende shkretëtirave të yjeve
Duke kërkuar dëshminë e agullimit,
Ndjeve gëzimin e lindjes
Kërceve e para në mes të botës
E purpurtë dole mes valësh
Dërgove gjer tej horizonteve të kaltër
Bekimin e rritur pagjumësisë së detit
Të ledhatoje flokët në pesë të mëngjesit.

Mbretereshë pulsesh e flatrash të Egjeut
Gjete me fjalë që afrojnë pafundësinë
Me zjarr me llavë me tym
Përvijimet e mëdha të fatit tënd

Tani para teje shpaloset drejtësia
Malet e murrme notojnë shkëndijimit
Dëshirat farkëtojnë krateret e tyre
Në truallin e munduar të zemrës
Dhe nga sfilatja e shpresës tokë e re gatitet
Që të ecë atje me shqiponja e flamuj
Një mëngjes mbushur me ylbere
Fisi që gjallëron ëndrrat

MOSHË E KUJTESËS KALTËRORE

Ullishta dhe vreshta deri tutje në det
Sandale të kuqe peshkatarësh më tutje deri në kujtesë
Këllëfe të arta gushti në gjumin e mesditës
Tërë leshterikë e guaska. Dhe ajo barkë
E blertë e sapo dalë që lexon ende ujrave paqesore
Të gjirit *Ka Zoti*

Kaluan vitet gjethe e guraleca
Kujtoj vocrrakët, marinarët që iknin
Duke lyer velat si zemrën e tyre
Këndonin katër anët e horizontit
Me murlanë në krahërorë pikturuar.

Ç' kërkoja ndërsa mbrite e nxirrë nga lindja e diellit
Me moshën e detit në sy
Dhe me shëndetin e diellit në trup – çfarë kërkoja
Thellë në shpellat detare mes hapësirës së ëndrrave
Ku shkumonte ndjenjat e saj stuhia
E panjohur dhe e kaltër duke gdhendur mbi gjoksin tim
Emblemën e saj detare

Me rërën gishtërinjve mbyllja gishtërinjtë
Me rërën syve shtrëngoja gishtërinjtë
Ishte brenga-
Mbay mend ishte prill kur ndjeva për herë të parë peshën
Tënde njerëzore
Trupin tënd njerëzor baltë dhe mëkat
Ashtu si ditën tonë të parë në tokë
Festoheshin amarilidat- Po mbaj mend pate dhimbje
Ishte një kafshim i thellë në buzë
Thonj ngulur thellë në lëkurë atje ku përvijohet përherë
Koha

Të lashë atëherë

Dhe një dihatje kumbuese ngrinte lart shtëpitë e bardha
Ndijimet e bardha të sapolara
Në qiellin që ndrinte me një buzëqeshje

Tani do të kem me vete një katruvë uji jetëdhënës
Do të kem një formë të lirisë së erës që shkundullon
Dhe ato duart e tua ku do të vuajë dashuria
Dhe atë guaskën tënde ku do të jehojë Egjeu.

MELANKOLI E EGJEUT

Ç'pleksje shpirti gjireve të mbasditës!
Ç'bunacë zërave të anëdetit të largët!
Qyqja mes kurorës së drurëve
Dhe çasti mistik i darkës së peshkatarëve
Dhe deti që luan me fizarmonikë
Bregën e largët të gruas
Bukuroshe që zbuloi gjinjtë
Kur kujtesa u fut në foletë
Dhe jargavanët stërpikën me flakë perendimin!

Me sandallin dhe velat e Shënmërisë
Ikën me përcjelljen e erërave
Dashnorët e mërgimit të zambakëve
Por nata si gurgullonte këtu gjumin
Me flokë të kulluara grykave të përndritura
Apo ranishtave të mëdha të bardha
Dhe me shpatën e artë të Orionit
Ç'u përhap duke vërshuar përpjetë
Pluhuri prej ëndrrave vajzërore
Që kundërmonin borzilok e mjedër!

Udhëkryqëve ku ndaloi magjistarja e vjetër
Duke përveluar me trumëz erërat
Hijet shtathedhura çapiteshin ngadal
Me një shtamb ujë të nemitur në duar
Me lehtësi sikur hynin në Parajsë
Dhe nga lutja e bulkthave që shkumoi fushat
Ia bëhen bukuroshët me lëkurë hëne
Për të vallëzuar lëmit të mesnatës...

O shenja që kaloni përmes thellësisë
Së ujit që mban një pasqyrë
Shtatë zambakëza që llamburisni

Kur të kthehet serish shpata e Orionit
Do të gjejë bukë të varfër poshtë kandilit

Por shpirt s' do të gjejë nën prushin e yjeve
Do të gjejë duar të mëdha degëzuar pafundësisë
leshterikë shkretanë krijesa të vogla të bregut
Vite korale të gjelbër


O koral i gjelbër-cili orakull stuhie të pa
Duke ndaluar dritën në lindjen e ditës
dritën në lindjen e dy syve të botës!

LINDJA E DITËS

Kur dita rritet prej kërcellit të saj dhe shpalosë gjithë
ngjyrat mbi dhe
Kur nga zëri në gojë thyhet stalagmiti
Kur dielli të notojë në një fushë të pakorrur si lumë
Dhe të vrapojë larg një velë bareshë vocrrake erërash
Gjithnjë uniforma jote është uniformë ishulli është
Mulliri që rrotullon së prapthi vitet
Vitet që jetove dhe pamjet e tyre i gjej të vuajnë në
krahërorin tim
Një kajsë përkulet mbi tjetrën dhe balta rrëzohet nga
krahët e ujit të sapozgjuar
Grerëza mbi trupin e qumështores shtrin flatrat e saj
Pastaj befaz fluturon dhe humbet duke zukatur
Dhe nga bulëza mbi gjeth dhe nga gjethi mbi statujë
Sa shkon gjithmonë e më tepër shndërrohet koha
Merr sendët që na shtyjme të të kujtojmë dhe gjithnjë
e më tepër i bën pjesë të fisit me dashurinë time
Po ajo dëshirë tirret përsëri
Gjithë trugu i drurit të diellit të zemrës së mirë digjet

Kështu të shoh ende në rrezën e ditës së përjetshme
Tek përgjon pulsën e anëdetit
Lindja asgjë nuk paska ndryshuar nga hareja jote

Lije një nuse të madhe shkume stolisje duke u ngjitur
Shkundje kryet e tua të lara si me sapun nga bukuria
mëngjesore
Kthjelltësia zgjeronte sytë e tua
Nuk qe enigmë që të mos shuhej që të mos bëhej tym
në gojë eoli
Ndryshoje stinët me duart e tua
Duke hedhur borëra dhe shira, lule, dete



Dhe dita ndahej nga trupi yt, ngjitej, çelej, bekim i madh
mbi lulediejt

Ç' di tani gjinkalla nga historia që le pas, çfarë di bulkthi
Kambana e fshatit që përhapet në erë
Vemja, krokulli, iriqi i detit, alfëza e ujit
Mirjada gojë thërrasin dhe të ftojnë
Eja pra t'i jetojmë ngjyrat nga fillimi
Të zbulojmë dhuratat e ishullit të zbuluar
Kupola të trëndafilta e të kaltra do të ringjallin ndjenjen
E fortë si krahëror ndjenja gati për të fluturuar
Eja pra të shtrojmë dritën
Të flemë dritën e kaltër në shkallët e gurta të gushtit

Ti e di çdo shtegtim u hapet pëllumbave
Gjithë bota mbështetet në det e në tokë
Do të kapim renë do të dalim prej gjemës së kohës
Nga ana tjetër e fatkeqësisë
Do të lozim diellin ndër gishtar tona
Rrethinave të zemrës së hapur
Do të shohim se si rilindë bota.

SHEGA E ÇMENDUR

*Pikëpyetje mëngjesore
dëfrim a perdre haleine*

Në këto oborre bardhëllore ku fryn juga
E fërshtëllen kamarave me qemerë, thomëni është shega e
çmendur
Që shpërthen në dritë duke shpërndarë buzëqeshjen e saj
pjalmore
Me zemëra të pëshpërima erërash, thomëni është shega
e çmendur
Që rrëqeth me gjethnajat mitare agullimin
Duke shpalosur përpjetë gjithë ngjyrat me drithërima
triumfi?

Kur fushave vajzat lakuriqe të sapo zgjuara
Korrin me duart e tyre bjonde tërflin
Duke dalë skajeve të gjumit, thomëni është shega e
çmendur
Që mbush e çlirët me drita kanistrat e brishta
Që nginj me cicërima emrat e tyre, thomëni është shega e
çmendur
Që përleshet me vranësirën e botës?

Ditën kur stoliset nga zilia me shtatë palë flatra
Duke lidhur brez diellin e amshuar me mijra ylbere
vërbuese,
Thomëni është shega e çmendur
Që rrëmben një jete me njëqind fshikullime në vrapin e saj
Herë e trishtuar e herë grindavece, thomëni është shega e
çmendur
Që thërret shpresën e re tek po lind?

Thomëni, është shega e çmendur që njetjeton largësive
Duke valëvitur një shami gjethesh prej zjarri të vesuar
Një det i mbarsur gati për të pjellë me njëmijë e një anije
Me dallgë që njëmijë e një herë nisnin dhe shtegtojnë
Brigjeve virgjërore, thomëni është shega e çmendur
Që dredh direktet dhe kërcëllin në eterin e kthjelltë?

Lartësive me biskun e kaltër që përflakët dhe kremton
Kryelart, plot rreziqe, thomëni është shega e çmendur
Që çan me dritë mospërmas botës stuhitë e demonit
Që shtrin tejtejet jakën, varëse të verdhëllemë të ditës
Të shumëqenditur kudo me këngë, thomëni është shega
E çmendur që me ngut shkopsit të mendafshat e ditës?

Kombinezoneve të fillimprillit dhe gjinkallave të
mesgushtit,
Thomëni, ajo që lodron, ajo që buthton, ajo që magjeps
Duke shkundur prej frikës terret e zeza të liga të saj
Duke lëshuar në gjinjtë e diellit zogjtë dehës, thomëni ajo
që
Shtrin flatrat në krahërorin e sendeve,
Në krahërorin e ëndrrave tona të thella, është shega e
çmendur?
me zogjtë puplorë
të verdhëremë të bigëzuar dhe diejt.
të vockël ratifikon rishtazi ligjshmërinë e së
Pashpresuarës.

Mario Luzi. Ky vëzhgues i mprehtë i heshtjes.

Është akoma një moshë, kjo e imja,
Kur pritët nga të tjerët ajo që gjendet
Brenda nesh, ose që fare nuk ekziston.
M.L.

E njoha poetin hermetik nga Firenze Mario Luzin vite më parë në të njëjtin qytet ku edhe banoj që prej 30 vjetësh. Kur erdha në Itali në Nëntor të 92-shit, isha një i ri 22 vjeçar, i cili nuk kishte ikur nga vendi i tij veç për arsye ekonomike. Mbi të gjitha, shtysa më e madhe kishte qenë etja për dije. Dëshira e zjarrit për të nxënë. Jo rastësisht, kisha marrë me vete edhe të gjitha dorëshkrimet që kisha në shqip. Poezitë edhe prozat e deriatëhershme, të cilat doja me çdo kusht t'i përktheja në italisht. Falë naivitetit të pashmangshëm, iluzioni i madhështisë më mbështillte si një najlon i shndritshëm. Atje, mbasi i zgjidha disi probleme burokratike, fillova të ndiqja ndërkohë edhe një kurs tremujor në Qendrën "La Pira", po në Firenze, ku kërkoja të perfeksionoja italishten time. Edhe pse fare fillestar, mundohesha të lexoja poetët italianë më në zë, si Quasimodo, Ungareti apo Montale. Ndodhi, ndërkohë që po ndiqja kursin, që një italian, i cili punonte aty, ndërkohë po më korrigjonte në italisht poezitë e para përkthyer nga unë më foli për Mario Luzin. "Pse nuk i telefonon!" Më sugjeroi, ndërkohë që e kishte gjetur emrin e tij tek lista ku ishin botuar të gjithë numrat e telefonit të qytetarëve florentinë. Ishte një libër i madh sa një fjalor. "S'e besoj!" i thashë. "Poeti s'ka kohë të merret me nxënë të panjohur! Pastaj unë nuk di as të flas mirë italisht". "Ti merre një herë në telefon. Provoje. Ai mund të të ndihmojë!" Nuk kaloi shumë kohë dhe kjo ide e cila më ishte ngulitur fort në kokë, në vend që të më shqitej, po më ngulej gjithnjë e më shumë në mendje. Pasuria e re shpirtërore, vargjet e poezive italiane, të cilat mundohesha t'i merrja kuptimin me fjalor në dorë, më ngjanin akoma më misterioze. Ashtu, me fjalët e panjohura përkthyer keq, bëheshin akoma edhe më torturose dhe hermetike se sa vetë poezia hermetike. Më bënte shumë kurioz Montale për shëmbull me vëllimin e tij poetik: "Ossi di Sepia". Po ashtu edhe poezitë e zgjedhura të Quasimodo më mahnisnin. Çdo varg i përkthyer me mundim ishte një perlë e re e zbuluar, për trurin tim të etur. Po i lexoja në origjinal dhe kjo ishte një fitore e madhe për mua. E kopjova numrin e telefonit të poetit Mario Luzi dhe e mbaja të shkruar në një pusullë. Një mbasdite, mora guximin dhe i telefonova. "Jam një poet i ri shqiptar!" i thashë. "Kisha shumë dëshirë t'ju takoja!" Dëgjova matanë zërin e tij: "Jeni këtu veç për disa ditë?" më pyeti ai. Mario Luzi kishte një zë të qetë, zë i cili i shëmbëlente më tepër mërmërimës intime të një shoku i cili të rrëfen gjëra në vesh. "Jo profesor. Kam ardhur për të kryer studimet për letërsi!" Për çudinë time më të madhe m'u përgjigj: "Prit pak sa të kontrolloj bllokun ku shënoj takimet." I habitur jo pak nga zemërgjërësia e poetit, më la të prisja për një kohë në telefon. Shkoi të shihte axhendën e tij personale për të gjetur një hapësirë të lirë për të organizuar takimet. Po prisja akoma me bririn e telefonit në vesh, kurioz që të dëgjoja akoma zërin e tij nga ana tjetër e linjës. Kur u kthye, ndërkohë që po shënonte orarin dhe datën e takimit, vazhdonte të fliste me zërin e tij, i cili dukej sikur buronte nga zgafellat e kohës së humbur. Ishte një zë i njëtrajtshëm, i cili ngjasonte herë si ai i njeriut të sapozgjuar nga gjumi i shekujve dhe herë ngjante me ato zanoret zvarritëse dhe, të stërzgjatura. Ishte si një pëshpërimë gjethesh vjeshtë. Luzi, siç do të shihja edhe më vonë, para se të ishte poet, ai ishte një njeri me zemër të madhe. Një i moshuar, i cili i përkiste një epoke tjetër njerëzore. Epokë, kur poetët mblidheshin bashkë dhe me zjarr diskutonin për poezinë dhe shkrimin nëpër kafenetë e qytetit si: "Le Giubbe Rosse", apo "Gambinus". Dhe ku ndjenja e miqësisë mes poetëve, ishte ndoshta më e fortë dhe e sinqertë se ngahera. Jo si në epokën e konsumizmit e cila e kishte vrarë

TAKIMET EMIA ME POETINE FAMSHËM ITALIAN, MARIO LUZI

Nga Artur Spanjoli

poezinë. Kohë krejt të reja për një shpirt ëndërrimtar dhe të ndjeshëm. Gjatë viteve në vijim i bëra më shumë se nja tridhjetë vizita poetit, në një hark kohor prej 12 vjetësh. Deri atë të martë 28 shkurti të vitit 2005 kur, mbasi qyteti e kishte nderuar për 90 vjetorin e lindjes me një festë gazmore në sallonin më prestigjioz të Firences: Il Salone del 500-nto, mbylli sytë disa muaj më vonë përjetësisht tek flinte i qetë dhe i vetëm në shtëpinë e tij të madhe në Via Bellariva. Një apartament i cili gjendej në katin e pestë. Më priste gjithmonë mbasditeve rreth orës pesë, në dimër apo në pranverë, dhe ato dy orë bisedash, gjatë viteve të universitetit, për mua ishin festa të vërteta. Orë bisedash të bukura mbi letërsinë dhe poezinë. Por, jo vetëm. Me Mario Luzi-n mund të diskutoje për mbi gjithçka. Bisedat fluturonin pa fund nëpër hapësirat e krijimtarisë, nëpër vargjet e poetëve si ato italianë ashtu edhe ata të francës. Luzi i donte shumë simbolistët francezë. Por ai njihje mirë edhe poezinë spanjolle, atë latino amerikane me Borghesin dhe Nerudën në krye. Deri edhe shkrimtarët më të mirë dhe më në zë që ishin në qarkullim. Kishte një adhurim të veçantë sidomos për tregimet e Tolstojit. E shihja poetin si një bibliotekë të pasur plot me dije. Një bibliotekë e privilegjuar sepse njohuritë që kishte përftuar në dhjetëvjeçarë leximesh, tani kishin privilegjin e madh të sintetizoheshin në laboratorin e tij krijues dhe të dilnin nga goja e tij në formë të kullur duke na dhënë veç sintezën. Ky ishte privilegji i madh i mençurisë së përftuar pak nga pak. Një akt, gjest dashurie e thellë ndaj jetës. Luzi ishte një besnik i fjalës. "Ia dola më në fund!" i thashë atë ditë Antonios. "Poeti pranoi të më presë në shtëpi!" "Çfarë, çfarë?" ma ktheu ai krejt i habitur, ndërkohë që po më vështronte me mosbesim. "Mario Luzi do të të presë në shtëpi!" Nuk e zgjata. Mora një hartë të qytetit dhe me laps nënvizova rrugën që do të bëja për të arritur në Via Bellariva 20 ku ndodhej shtëpia e tij. Pastaj vrisja mendjen se si të arrija atje. Ishte pranvera e vitit 1993. Gjithkund lulet çilnin



përgjatë lumit Arno, dhe të dy krahët e tij ishin mbushur me aromat e gjelbra të pemeve të sapo çelura. Duke ndjekur hartën të cilën e shtrëngoja me thonj në dorë u ndala tek rruga ku gjendej pallati ku jetonte poeti. Zemra më rrihte fort. Nuk doja t'i bija ziles para orarit që kishim lënë ndaj sillesha për qark krejt i emocionuar. Kisha blerë tek libreria Feltrinelli librin e përkthyer italisht të Kadaresë «Kronikë në gur», por mbaja gjithashtu në një dosje disa nga krijimet e mia poetike. I rashë ziles dhe po prisja. Ndërkohë dëgjova të njëjtnë mërmërimë zëri, të mbytur. Më ftoi të merrja

ashensorin në të djathtë. Ishte një pallat i viteve 50, i cili ndodhej përgjatë lumit Arno. Një lumë i qetë dhe tinzar i cili shpesh, me shirat e rrëmbyeshëm të nëntorit ishte kthyer në kërcënim për qytetin sepse mund të dilte nga çasti në çast nga shtrati i tij i ngushtë. Mora ashensorin me drojën e shkollarit që do të takojë një poet i cili kishte kaluar të gjithë rrymat letrare të 900-tës dhe u ndjeva akoma edhe më i emocionuar. Profesori, kur priste miq, linte gjithmonë portën kryesore pak hapur dhe nuk i priste kurrë miqtë tek dera. Futej në guzhinë apo në dhomë, ndaj shtyva derën me një përsëritje të drojtur nxënësi dhe fillova të eci në sallonin e tij kredhur në gjysëm errësirë. Më dukej sikur po ecja në një kohë tjetër. Një kohë e mbetur pezull që prej 50 vjetësh kur arti i poezisë dhe i shkrimit ndoshta dashurohej më shumë. Era e fortë e letrave, e librave të vjetër dhe e objekteve të vjetra m'i mbushi hundët me kohën e ikur. Shtëpitë e të moshuarve Fiorentinë kishin gjithmonë diçka të veçantë. Dukej se i kishin rezistuar fare mirë epokës së konsumizmit, ndaj kishin ruajtur me fanatizëm jo vetëm sendet, stolat, kornizat, sixhadet, librat e vjetër në radhë, por, edhe aromat e mugëta dukej sikur kishin mbetur pezull që prej shumë dhjetë vjeçarësh. Tani tek ecja i vetmuar, i kredhur në gjysmëhijë e korridorit, heshtja dukej se i bënte të përjetshme kornizat me piktura varur gjithkund. U ndjeva si brenda një tregimi të Borgesit ku vibronte ëndërra me tërë forcën e saj. Në fund të korridorit gjendej një derë e hapur nga ku futej drita me vull dhe nga ku dallohej një bibliotekë e madhe sa një faqe muri. Ajo ishte studioja ku ai krijonte. Poeti m'u shfaq i gjatë dhe i qeshur. Kishte një fizik të thatë dhe fisnik, pak i kërrusur nga mosha, por njerëzillëku i tij i heshtur, intimiteti i tij tejet njerëzorë, më bëri që të ndjehesha përnjëherësh si në shtëpinë time. Që nga fjalët e para që shkëmbyem e ndjeva se ai, para së gjithash ishte njeri zemërgjërë, modest dhe shumë i thjeshtë në komunikim. "Eja, eja. Uluni këtu!" pëshpëriti me zërin e tij të butë dhe më tregoi rrugën për tek dhoma ku priste miqtë e tij. Ishte i njëjti zë, pak si i ngjirur, i beftë, me bashkëtingëlloret si të zvarritura në pluhur, dhe me zanoret që i zgjaste paksa gjatë shqiptimit, ndërkohë që mundohesh të gjente fjalët e duhura. Me Mario Luzin më dukej sikur flisja me një njeri i cili jo vetëm që i kishte mbijetuar kohës dhe luftërave, por dukej sikur enkas ishte tërhequr nga jeta për ta vëzhguar atë nga majat e parnastit të tij. Nuk kisha pasur kurrë rast, të paktën deri tani, që të njihja një njeri, i cili jo vetëm arrinte të shprehej aq bukur, por që kishte akumuluar në mendjen e tij aq shumë njohuri, aq shumë vargje, thënie, të kishte lexuar aq shumë libra sa të ilustronte çdo bisedë aq bukur. Mençuri letrare të cilën ai e formulonte pak nga pak, me kujdes. Dhe bisedat ishin pa fund. Nga Dante deri tek poetët bashkëkohorë. Për Danten thonte për shëmbull. Arrin të trasformoj një diçka në fjalë. Dhe një fjalë në diçka. Ndërsa poezinë, Mario nuk e shikonte si kremtim i ekzistencës, por si dëshira mbi diçka që nuk ishte, që nuk ekzistonte por që duhej të vinte. Ndaj, ishte kjo pritje ndaj diçkaje që mund të vinte, arsya që kishte ushqyer edhe punën e tij deri në fund. "Është kjo", thoshte Mario, "arsyeja e fuqisë dhe energjisë time që e ruaj akoma edhe në këtë moshë". Poeti rrezatonte nga e gjithë qenia e tij një njerzillëk të habitshëm. Ndjehej fare qartë natyra e tij e butë e mirë, e ekuilibruar, i cili me një buzëqeshje të rezervuar, me sytë e vegjël plot shkëndija jete, pak të trishta por, tepër fisnikë, rrinte dhe më vështronte plot kërshtëri. Gjatë takimit të parë më ftoi të ulesha në një karrigë të thurur me fije xhunkthi dhe bambu, e cila ndodhej përballë karrigës ku ai rrinte. Poeti u ul në krahun tjetër. U mbështet mbi shpinore, dhe ndenji këmbë përmbi këmbë, për çaste të tëra. Disi i kërrusur nga vitet, me pak bark, me sytë e vegjël dhe tejet njerëzorë, Luzi po dilte përpara meje me gjithë modestinë dhe thjeshtësinë e një shpirti të madh. Ishte një dhomë e vogël me dritaren e madhe nga ku bashkë me dritën e mbasdites, dukej sikur depërtonte edhe heshtja meditative e shekujve. Prapë poeti më kërkoi leje dhe u zhduk sërisht

Për popujt që jetojnë afër njëri-tjetrit me kufij të pandryshuar dhe që të tjerët i kanë vendosur të bashkëjetojnë në histori, letërsia paraqet një prej sfidave më të arsyeshme, që ta relativizojë qenien e tyre dhe vendin ku ndërtojnë urat midis tyre. Me shekuj, shqiptarët dhe maqedonasit kanë jetuar pranë njëri-tjetrit dhe kanë ndarë mes tyre kufirin që e kanë vendosur të tjerët. Periudha të errëta distancimi ka patur mes tyre, gjer në armiqësi. Sot, për fat të dy popujve, ky kufi e ka humbur kuptimin e mëparshëm dhe paraqet një portë të hapur për të dy popujt. Mes këtyre dy shteteve miqësore, ku Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë të njëjtat synime para integritetit evropian, letërsia ka qenë dhe mbetet si një nga urat më të forta. Një plejadë e rëndësishme shkrimtarësh shqiptarë si Lasgush Poradeci, Ismail Kadare (me shumë vepra), Fatos Arapi, fitues i Kurorës së Artë në Mbrëmjet e Poezisë në Strugë, Xhevair Spahiu, Visar Zhiti, Azem Shkreli, Ali Podrimja Dritëro Agolli (me poezi dhe prozë), Anton Pashku, Arian Leka, Agron Tufa, Sterio Spasse, Ylljet Aliçka, Besnik Mustafaj, Mira Meksi edhe shumë të tjerë, me veprat dhe antologjitë e ndryshme me poezi dhe prozë, janë të përkthyer dhe botuar në gjuhën maqedonase. Për t'u theksuar janë edhe autorët maqedonas që janë botuar në shqip, si Koço Racini, Bllazhe Konevski, Mateja Matevski, Gane Todorovski, Petre M. Andreevski, Ante Popovski, i riu Goce Smilevdki etj. Ekziston një marrëdhënie e vlefshme në të dy kahet, pra i veprave letrare në të gjitha periudhat kohore, madje edhe kur marrëdhëniet politike në mes këtyre dy shteteve ishin të rënduara. Një përpjekje shumë e vlefshme ekziston në tematikat historike për mbështetjen e identitetit maqedonas sidomos te autorët e vjetër dhe bashkëkohorë shqiptarë. Në këtë vazhdë të botimit të veprave të përkthyer në gjuhën maqedonase është dhe romani i shkrimtarit të njohur shqiptar Luan Rama. Një erudit brilant letrar që e mban në një nivel të lartë interesin dhe lexuesin e vet. Autor i katër skenareve filmike, i mbi gjashtëdhjetë veprave letrare dhe i dhjetra përkthimeve, në pak kohë Luan Rama i ka kushtuar krijimeve të mirëfillta letrare, d.m.th «zhanreve kryesore». Kjo mund të theksohet për romanin e ri të shkurtër «Dashuri e nëmur në Maligrad» (një përkthim i suksesshëm në maqedonisht prej Daut Dautit), në botimin e «Jon Media». Në një hapësirë të vogël narrative, autori vë në lëvizje veprime shumështrësore: ngjarje rreth fazave të ndryshme të një punonjësi në drejtorinë e trashëgimisë kulturore të qytetit të Korçës, i quajtur Edi, i cili dashurohet me një mësuese të re maqedone nga Pusteci, buzë liqenit të Prespës. Rrjedha e dytë narrative që konsiderohet edhe si më e rëndësishmja, është dashuria e një ushtari çek të ushtrisë austro-hungareze në kohën e Luftës së Parë Botërore, i cili është dashuruar me një vajzë të fshatit Pustec, në frontin shqiptaro-maqedonas.

Botohet në maqedonisht romani “Dashuria e nëmur në Maligrad” i shkrimtarit Luan Rama

Dëshmia romaneske për një dashuri shekspiriane

Parathënie nga Luan Starova



Por të dashuruarit janë zhdukur në mënyrë misterioze dhe trupat e të dyle asnjëherë nuk janë gjendur.

Faza e tretë në roman është po ashtu e rëndësishme. Ngjarjet janë të lidhura me farmacistin Stavri nga Korça, i cili në vitet e 60-të shekullit të kaluar, gjatë studimeve të tij në Pragë, ishte dashuruar me një vajzë çeke, me të cilën më pas krijoi familjen e tij në Korçë. Mirëpo kur marrëdhëniet në mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik u prishën, gruaja e Stavrit sikurse edhe gratë e tjera të huaja të ardhura në Shqipëri nga kampi socialist, u detyruan të kthehen në shtetet e tyre.

Zhvillimi fillestar në roman nis në vitin 1990, kur në gjendjen kaotike të vendit, të rinjtë duke mërguar jashtë vendit drejt Italisë, Greqisë e në vendet e tjera të Europës perëndimore,

kërkonin lumturinë. Në këto ngjarje të paparashikuara dëmtohen edhe kishat. Edit i duhej të inspektonte kishën e Maligradit, ku ka dhe rastin të ngjitet në Shpellën e Eremitëve në shkëmbenjtë e liqenit. Këtu ai do të gjejë një aparat të vjetër fotografik dhe sende të tjera ku përmes një ditari, shpejt do të zbulohet se kanë qenë të një ushtari të huaj të Luftës së Madhe. Ngjarjet reale përzihen me legjenda: në realitet, në bregun e liqenit egziston një gur i madh i zi, që ka lidhje me vrasjen e një ushtari të huaj, i dashuruar në një vajzë vendase të ndonjë shtëpie të bregut të liqenit. Edin nis të hulumtojë: ai shkon të takojë një fotograf në Korçë ku do të zhvillojë filmin e vjetër të aparatit të gjetur. Kështu nisnin të zbulohen personazhet e vërtetë të ngjarjes së dikurshme misterioze: në një prej fotografive, zbulohet Jaromiri,

ushtari çek, flautist dhe vajza fshatare nga Pusteci. Me ndihmën e Stavrit që njeh gjuhën çeke, ai deshifron se çfarë është shkruar në ditarin e ushtarit dhe shpreson të kontaktojë njerëzit e familjes së tij. Edi vazhdon të kërkojë: me këmbëngulje do të zbulojë se çfarë ka ndodhur në të vërtetë me ushtarin dhe vajzën fshatare. Në një nga fotografitë e aparatit të vjetër, shihet dera e madhe e familjes Shtëmbaçi. Edi takohet me plakun e familjes i cili e mban të fshehtë dhe nuk e tregon historinë e asaj ngjarje së hershme. Më në fund, pas shumë mundimeve dhe ballafaqimeve, e vërteta del në shesh: të dashuruarit, ushtari çek dhe vajza prej Pusteci rezultojnë se janë vrarë dhe se vajza është varrosur tek Guri i Zi. Vrasja qenka kryer prej një fqinji të tyre, të cilit i ishte premtuar vajza që në vogëli nga babai i saj se do martohej me të, por në ditën kur të dashuruarit po përgatiteshin për të ikur, ata janë vrarë nga xhelozia, dhe vrasësi ishte mbyllur në shpellën e eremitit. Në fund, edhe familja e ushtarit Jaromir do ta njohë të vërtetën, një dramë që prindërit e tij asnjëherë nuk e morën vesh. Për ta, zhdukja e djalit të tyre në kohën e Luftës e Madhe, kishte mbetur një mister. Romani mbaron me absurdin e luftës që vret një dashuri shekspiriane mes një ushtari çek dhe bukuroshes nga Pusteci. Lexuesi ka përshtypjen se autori Luan Rama në romanin e vet «Dashuria e nëmur në Maligrad», i mbetet besnik narrativës së vet romaneske. Në një rrëfim tregimtar të më shumë se njëqind faqeve, ai arrin të lidhë me sukses periudhën historike të Luftës së Parë Botërore me vitet '90 të shekullit të kaluar në Shqipëri, pas rënies së komunizmit stalinist dhe me Shqipërinë bashkohore duke gërshetuar një tregim të besueshëm, atë të dashurisë me ngjarje reale dhe mistike. Rama është autor me erudicion të fortë, njohës i shkëlqyer i ngjarjeve historike që e lidhin Shqipërinë me Francën edhe me Perëndimin. Duke e lexuar romanin «Dashuria e nëmur në Maligrad», fitohet përshtypja sikur lexojmë «disa romane të shkruara në një». Ky fakt sigurisht i jep vlerë romanit, i cili ka forcë koherente në tërësinë e vet romaneske, ku veprimi i ngjarjes mbahet homogjen. Në këtë roman, shkrimtari Rama mban një baraspeshë të suksesshme në mes të rëfimit historik dhe atij fiktiv. Romani është shumë joshës edhe për shumë nga ngjarjet e ndryshme historike, sidomos për periudhën e Luftës së Madhe, specialiteti i veçantë i autorit. Botimi i romanit «Dashuri e nëmur në Maligrad» në gjuhën maqedonase, me materien e vet shumëngjyrëshe, domethënëse për të kaluarën historike të përbashkët në periudhën gjatë Luftës së Parë Botërore, me qëndrueshmërinë e vet estetike, përvijon me sukses traditën e deritanishme të romaneve të botuara të shkrimtarëve shqiptarë (Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi etj.). Dhe jo vetëm ajo: Rama sjell një botë të re joshëse që sigurisht do të jetë me interes të veçantë për lexuesit maqedonas...

Në 1944, kur poeti dhe muzikanti, ikona botërore Leonard Cohen ishte nëntë vjeç, babai i vdiq. Leonard shkroi një poezi, e futi mes palave të papijonit të parapëlqyer të të atit dhe e varrosi në kopshtin e familjes së tij në Montreal. Kjo ishte shprehja e tij e parë artistike. Kjo mund t'i ketë jehuar atij sërish e sërish përgjatë gjashtë dekadave me *Grammy Lifetime Achievement Award*, shkrimin e qindra vargjeve për dhembjen e zemrës, mallin dhe dashurinë.

Cohen ishte sensual, romantik dhe xhentëlmen i njohur. Joni Mitchell e quajti njëherë "poeti boudoir". Ai kishte një zë hipnotizues dhe një karizëm të turpshme. Por asnjëra nga historitë e tij të dashurisë nuk zgjati; si një artist ai "rronte më së miri në gjendjen e mallit" sikurse biografi i tij Sylvie Simmons vëren.

Ndoshta dashuria e tij më e madhe ishte një bukuroshe norvegjeze e quajtur Marianne Ihlen. E takoi në ishullin grek të Hydras në 1960 ku ishte krijuar një komunitet artistik me shpirt të lirë. Cohen ishte shkrimtar atëherë. Edhe për gjashtë vite të tjera nuk mundi t'ia përngjiste muzikës poezitë e tij. Çdo mëngjes punonte në një roman dhe në darkë luante ninulla për djalin që Marianne kishte me një tjetër burrë. Ata jetonin në një harmoni tipike vendase "Ishte sikur të gjithë ishin të rinj, të bukur dhe me plot talent, mbuluar nga një lloj pluhuri i artë," tha ai më vonë për kohën në Hydra. "Të gjithë kishin cilësi të veçanta dhe unike. Kjo ishte, me siguri, ndjenja e rinisë, por në ambientin e lavdishëm të Hydras, gjithë këto cilësi ishin zmadhuar."

Por Leonard dhe Marianne duhet ta linin ishullin përfundimisht: ai për të fituar diçka për të jetuar në Kanada, ajo në Norvegji për arsye familjare. Provuan të rrinin së bashku, por nuk ja dolën ta bënin të zgjaste. Ai u zhvendos në New York City, u bë një muzikant, u fshi nga një skenë e cila kurrë s'i ishte përshtatur. "Kur jeton në Hydra," tha më vonë, "nuk mund të jetosh asgjëkundi tjetër, përfshirë Hydran."

Ai vazhdoi me jetën e tij, Marianne me të sajën, por ajo frymëzoi disa nga këngët e tij më ikonike rreth braktisjes. Ato kishin tituj si "So Long, Marianne" dhe "Hey, That's No Way to Say Goodbye". "Janë disa njerëz që anojnë nga përsëritja," tha Cohen për muzikën e tij, "por unë, përkundrazi jam më shumë i lamtumirës."

Hiti i tij i fundit, realizuar tre javë para se të vdiste në moshën tetëdhjetëvjeçare, titullohej "You want it darker".

Gjendjet e trishtuara shpirtërore prirën ta formësojnë vëmendjen tonë: Ato na përqendrojnë më shumë dhe na drejtojnë nga detajet, në përmirësojnë kujtesën dhe themelet e njohjes. Edhe ata që e adhurojnë punën e tij, komentonin rreth natyrës së saj të zymtë. Një nga shtëpitë e regjistrimit bënte shaka rreth zëvendësimit të brisqeve me albumet e tij. Por kjo është një mënyrë e kufizuar për të menduar për të. Ai ishte në të vërtetë një poet i errësirës dhe dritës, i "Alelujas së ftohtë e të thyer", sikurse shkruan në këngën e tij më të njohur. Cilëndo dhimbje që s'mund ta largosh, thoshte, blatoje për kreativitetin tënd.

A është kreativiteti i lidhur me pikëllimin dhe mallin ndërmjet disa forcave misterioze? Pyetja është shtruar prej kohësh nga studiues të kreativitetit të rastësishëm. Dhe të dhënat, (ashtu sikurse intuita e Aristotelit për mbizotërimin e melankolisë në art) thotë se përgjigjja është po. Bazuar në një studim të njohur e të hershëm të 573 liderëve të krijimtarisë nga psikologu Marvin Eisenstad, një përqindje çuditërisht e lartë e krijuesve, sikurse Cohen, kishin mbetur jetimë në fëmijëri. Njëzetepesë përqind kishin humbur të paktën njërin prind deri në 10 vjeç; tridhjetekatër deri në pesëmbëdhjetë dhe dyzetepesë deri në njëzetë.

Studime të tjera thonë se edhe artistët, prindërit e të cilëve rrojnë deri në pleqëri,

A EKZISTON NDONJË LIDHJE E QENËSISHME MES MËRZISË DHE TË BËRIT ART?

Nga Beethoveni te Leonard Cohen, Susan Cain përsiat rreth melankolisë dhe kreativitetit

Përktheu Andreas Dushi



janë në mënyrë disproporcionale të prirur drejt pikëllimit. Ata që punojnë me artin kanë tetë deri në dhjetë herë më shumë mundësi të vuajnë nga çrregullime të humorit, bazuar në një studim të 1993 nga profesori i psikiatrisë në *John Hopkins*, Kay Redfield Jamison. Në studimin e tij mbi psikikën artistike, *Tortured Artist*, botuar në 2012 ku profilizohen dyzetetë artistë nga Michelangelo te Madona, autori Christopher Zara zbuloi se historitë e jetëve të tyre ndanin një masë të caktuar dhimbjeje dhe vuajtjeje.

Dhe në 2017, një ekonomist i quajtur Karol Jan Borowiecki botoi një studim magjepsës në *The Review of Economics and Statistics* të quajtur "Si je ti, Mozarti im i dashur? Mirëqenia dhe kreativiteti i tre kompozitorëve të famshëm bazuar në letrat e tyre". Borowiecki përdori një program analitik gjuhësor për të studiuar 1400 letra të shkruara nga Mozarti, Listzi dhe Beethoveni përgjatë jetëve të tyre. Ai gjurmoi kur letrat e tyre i referoheshin emocioneve pozitive (duke përdorur fjalë si lumturi) ose atyre negative (fjalë si mjerim) dhe se si këto ndjenja lidheshin me sasinë dhe cilësinë e muzikës që ata kompozonin në atë kohë. Borowiecki zbuloi se emocionet negative të artistëve nuk ishin vetëm të ndërlydhura, por edhe parathënëse të krijimtarisë së tyre. Dhe se jo çdo emocion negativ kishte këtë ndikim. Sikurse studiuesit e muzikës kanë zbuluar se mërzia është i vetmi emocion negativ që kur kthehet në muzikë nxitet brenda nesh, Borowiecki zbuloi se ajo ishte gjithashtu "ndjenja kryesore negative që nxit krijimtarinë".

Në një tjetër studim intrigues, profesori në Columbia Business Choll, Mopude Akinola mblodhi një grup studentësh dhe

matë në gjakun e tyre DHEAS, një hormon që ndihmon në mbrojtjen përballë depresionit duke sulmuar efektin e hormoneve të stresit si kortizoli. Pastaj u kërkoi studentëve të flisnin para një publiku për punën e tyre të ëndrrave. Pa e përfshirë në studim, ajo u mor vesh me publikun në të tillë mënyrë që disa nga ligjërimet t'i mbështesnin me buzëqeshje e miratime, ndërsa përballë të tjerëve të lëviznin kokën e rrudhnin vetullat.

Mandej i pyeti studentët si ishin ndjerë. Ashtu si pritej, ata që ishin përballur me miratim ishin më në humor se të tjerët. Por u kërkoi studentëve gjithashtu të bënin një kolazh me profesionet artistike që do të donin të ndiqnin. Ata që ishin përballur me mosmiratimin e audiencës përgatitën kolazhe më të mira sesa ato të përballur me buzëqeshje. Dhe ata që kishin marrë një *feedback* negativ nga publiku dhe kishin nivel të ulët të DHEAS, pra studentët që ishin njëkohësisht emocionalisht të brishtë dhe vuanin refuzimin nga publiku, bënë kolazhet më të bukura.

Studime të tjera kanë zbuluar se gjendjet e mërzitura janë të prirura ta formëzojnë vëmendjen tonë: Ato na bëjnë më të fokusuar dhe orientuar nga detajet, na përmirësojnë kujtesën, korrektojnë bazat njohëse. Për shembull, profesori i psikologjisë në Universitetin e New South Wales, Joseph Forgas zbuloi se njerëzit janë më të zotë të kujtojnë gjera që kanë parë në një dyqan gjatë një dite me re krahasuar me ditët me diell dhe se njerëzit në humor të keq (pasi u kërkua të përqendroheshin në kujtime të trishta) kishin një kujtesë vizive më të mirë të një aksidenti me makinë sesa kur u kërkohet të mendonin për kohë të lumtura.

Ka shumë shpjegime të mundshme, patjetër, për zbulime të tilla. Ndoshta është vëmendja e theksuar që sugjerojnë studimet e Forgasit. Ose ndoshta pengesat emocionale rrënjësojnë një gradë më shumë force karakteri dhe këmbëngulje, të cilën disa njerëz e aplikojnë në përpjekjet e tyre kreative; studime të tjera sugjerojnë se fatkeqësitë shkaktojnë një prirje tërheqjeje në një botë të brendshme imagjinare.

Sido të jetë teoria, nuk duhet të bëjmë gabimin që ta shohim errësirën si katalizatorin fillestar apo të vetëm ndaj kreativitetit. Në fund të fundit, shumica e njerëzve kreativë janë tipa optimistë. Dhe studimet tregojnë gjithashtu se pulset e mprehtësisë ka më shumë gjasa të ndodhin kur jemi në humor të mirë. E dimë gjithashtu se depresioni klinik – të cilin e mendojmë si një vrimë e zezë emocionale që shuan të gjithë dritën – e vret kreativitetin. Siç i ka thënë profesori i psikiatrisë te Universiteti i Columbia revistës *Atlantic*, "Njerëzit krijues nuk janë krijues kur janë të depresionuar."

Në vend të kësaj, mund të jetë më e dobishme që ta shohim kreativitetin përmes lentës së ëmbëlsisë së hidhur – të përleshjes të njëkohësisht të errësirës dhe dritës. Nuk është dhembja e barabartë me artin. Është fakti që kreativiteti ka fuqinë ta shohë dhimbjen në sy, dhe të vendosë ta kthejë në diçka më të mirë. Siç sugjeron historia e Cohenit, kërkimi për transformimin e dhimbjes në bukuri është një nga katalizatorët më të mëdhenj të shprehjes artistike. "Ai ndihej si në shtëpi me errësirën, mënyra si shkruante, mënyra si punonte," vuri re Sylvie Simmons. "Por në fund, e gjitha ishte për të gjetur dritën."



PRANVERA e Sandro Botticelli

Dr. Bledar Kurti

Arti e ka shoqëruar njeriun që në ditën e tij të parë. Madje arti lindi bashkë me njeriun, dhe me të zbuluar aftësinë e tij për të krijuar, goftë kjo për të imituar natyrën apo për të prodhuar imazhe përtej natyrës, njeriu artist zhvilloi edhe aftësinë e tij për të sfiduar kohën dhe hapësirën, duke përmbledhur brenda një krijimi, tabloje, skene, apo momenti artistik, të tre aspektet e kohës: të shkuarën, të tashmen, dhe të ardhmen. Ndaj do ishte e gabuar që një artist të etiketohej vetëm si krijues figurash, i shkëputur nga historia, qytetërimi, filozofia, letërsia, shkenca, novacioni, anatomia, gjeologjia, bimësia, etj., me fjalë të tjera nga të gjithë fushat e jetës, të shtyra nga përvoja e së kaluarës por të nxitura nga sfidat e së ardhmes.

Duke mos qenë i kufizuar nga koncepti i kohës, artisti krijon duke ilustruar atë që bota ka lënë pas krahëve por duke sjellë risi e duke dhënë një mesazh për epokat e së ardhmes. Dhe tabloja *Pranvera* (1482) e Sandro Botticelli (1445–1510) është piketa më e rëndësishme në epokën e re të qytetërimit perëndimor, e cila mori hovin e saj kontinental e më pas botëror me Rilindjen, periudhën e zjarritë kulturore, artistike, politike dhe ekonomike, e përshkruar përgjithësisht nga shekulli 14-të deri në shekullin e 17-të, e cila promovoi ri-zbulimin e filozofisë, letërsisë dhe artit klasik.

Piktura e Botticelli-t shënoi një pikë kulmore në evolucionin e sistemeve të mëdha të artit të ndërtaura në gjysmën e parë të shekullit të 15-

të. Konceptimi i hapësirës dhe i perspektivës, konceptimi i formës si njohuri ose përfaqësimi i natyrës, nocioni i historisë si figurimi dramatik i veprimeve njerëzore, roli i etikës dhe fesë në art, statusi i artistit në tërësi, u sfiduan dhe u rishikuan nën dritën e arritjes së “bukurisë”, e cila tashmë po e devijonte rrjedhën e artit, ashtu siç kishte devijuar prirjen e mendimit filozofik, apo ngjyrosur studimin humanist të antikitetit dhe kishte ndikuar në standardet morale. Rezultati ishte që në art, ashtu si edhe në fusha të tjera, nuk ishte më e rëndësishme arritja konkrete e një krijimi por kërkimi ndaj bukurisë.

Kësisoj për herë të parë në historinë e artit evropian një piktor i vuri qëllimin ekskluziv vetes të kërkonte bukurinë. Ky piktor ishte Sandro Botticelli, dhe vepra e tij *Pranvera* është simbol i këtij pelegrinazhi në zbulim të bukurisë.

E pikturuar për të nderuar martesën e Lorenzo di Pierfrancesco de Medici, pjesëtar i familjes së rëndësishme të Firences, bankierët më të fuqishëm për të gjithë monarkët e Evropës, *Pranvera* e Botticelli-t, u vendos jashtë dhomës martesore në pallatin e tij, e konceptuar më shumë si një tapiceri e stilit flamand sesa pikturë. E mbushur me referenca mitologjike, shumë elementë në tablo duket se i referohen edhe familjes Medici. Ngjyra portokalli e frutave dhe e pelerinës të Venusit dhe Mërkurit janë ngjyra e familjes Medici. Por kjo pikturë shkon përtej simbolit të martesës së çiftit të ri, dhe patronazhit të familjes

së pasur fiorentinase, ajo shpalos një qasje të re artistike dhe hapi dyert për t'i treguar njerëzimit një fytyrë të re të artit.

E gjithë tabloja është poezi.

“Teksa ajo flet, nga buzët e saj çelën trëndafilat: Unë isha Kloris, e tani unë quhem Flora,” shkroi Ovidi, tek poema *Fasti* në vitin 8 pas Krishtit. Ky varg duket se e frymëzoi artistin për këtë tablo e cila ende më sot mbetet vepra ikonë e shkrirjes së trupit njerëzor me natyrën.

Kjo tablo ka nëntë personazhe, pak a shumë të gjithë në plan të parë. Dy burra, gjashtë gra, njëra prej të cilave është e pozicionuar në qendër por disi e tërhequr për të lejuar skenën të zhvillohet përpara saj. Dhe, mbi të, na shfaqet një engjell me krahë në fluturim.

Figurat janë elegante dhe harmonike. Ato janë të vendosura në një kopsht, të rrethuar nga një pemishte. Në paraqitjen e bimëve dhe barit, Botticelli krijon një skenë aq të saktë duke përfaqësuar mbi 190 lloje të ndryshme bimësh, të zgjedhura nga ato që lulëzonin në fshatrat fiorentinë gjatë periudhës midis muajit mars dhe maj, pra gjatë stinës së pranverës.

Interpretimi i veprës është kompleks dhe përmban edhe të fshehta. Duket se përmban një gjuhë të koduar që vetëm ata që i përkisnin rrethit të brendshëm të familjes Medici dhe intelektualëve humanistë të asaj kohe ishin në gjendje ta kuptonin. Por edhe sot ne arrijmë të gjejmë kuptimin e përgjithshëm prej elementeve të saj të shumtë.

Në të vërtetë, piktura nuk ka titull.

Emrin *Pranvera* e mori 70 vjet pas përfundimit, kur biografi i njohur dhe artisti Giorgio Vasari e pa dhe vendosi ta titullojë kështu. Në këtë vepër, referencat letrare, filozofike dhe ikonografike janë të shumta e të ndërlikuara dhe janë të lidhura me filozofinë neoplatonike dhe me literaturën humaniste dhe latine, më të lexuarat gjerësisht në atë kohë. Për këtë arsye, dhe për shkak të mungesës së titullit, kjo vepër ka patur interpretime të ndryshme. Sipas interpretimit më tradicional, piktura duhet të lexohet nga e djathta në të majtë. Të vërtetat morale shprehen përmes miteve. Skena zhvillohet në kopshtin e Hesperideve, bijave të natës të cilat ishin rojtare të kopshtit ku rriteshin mollët e arta të pavdekësisë.

Tabloja ofron një koleksion të gjerë figurash të cilat na shtyjnë të pyesim veten se nga vjen ky bashkim i njerëzve dhe i gjërave. Sigurisht jo nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë i botës reale. Figurat kanë simbolika mitologjike, por modelet dhe përbërësit e kopshtit janë studime të natyrës dhe botës reale.

Në këtë kopsht të përsosur të rrethuar me portokalle dhe dafina, figura e parë në të djathtë është Zefiri, era që lajmëron ardhjen e pranverës. Ai paraqitet në tablo duke përfaqësuar nimfën Kloris, të cilës falë atij kontakti i dalin lule nga goja. Pas bashkimit të tyre, nimfa transformohet e shndërrohet në një krijesë tjetër, në perëndeshën Flora, mbrojtëse e bujqësisë dhe e pjellorisë femërore.

Falë ndërmjetësimit të Venusit, perëndeshës së bukurisë dhe dashurisë, e veshur me hijeshi dhe e kompozuar në qendër të pikturës, dashuria fizike dhe frymore e Zefirit dhe Klorisë shpaloset e ngritur mbi figurat e tjera me bukurinë dhe përsosmërinë e saj.

Më pas vijnë tri hiret, bijat e Zeusit, të cilat në mitologji përfaqësojnë bukurinë, lulëzimin dhe gëzimin, dhe shigjeta e Kupidit që fluturon mbi Venusin drejtohet për nga ato. Tri hiret vallëzojnë në formë rrethore, duke shtrënguar duart lart në një prekje ikonë që shpalos një imazh të lehtë në ajër. Në të majtë, në fund të tablosë gjendet Mërkuri, perëndia e begatisë dhe e tregtisë, por i njohur edhe si lajmëtar i zotave. Ai largon retë nga qielli, për të mbrojtur përsosmërinë e atij kopshti. Falë tij, skena merr një dimension të mëtejshëm në sferat qiellore.

Portreti i Mërkurit ngjason shumë me atë të Lorenzo di Pierfrancesco, porositësin e veprës, dhe nusja e tij Semirande ngjason me Florën. Duke konsideruar ngjashmërinë me Lorenzo, bankierin e pasur, dhe faktin që Mërkuri simbolizonte pasuri, mbetet për t'u besuar që çifti i ri është pikturuar në këtë vepër dhe simbolika e pjellorisë shërben si një urim për ripërtëritje të jetës, dashuri dhe lindje pasardhësish. Gjithashtu vërehet se portreti i Venusit ngjason me Simonetta Vespucci, gruan më të bukur të Firences, bashkëshorten e Marco Vespucci, e cila mund të kishte lidhje dashurore me Giuliano de' Medici, por nuk përjashtohet edhe mundësia që Botticelli të ishte i dashuruar me të, ndaj edhe portreti i saj gjendet edhe tek vepra tjetër tejet e njohur *Lindja e Venusit*.

Ngjyra e errët e bimësisë ka ndodhur

pjesërisht për shkak të procesit të kohës dhe vjetërimit të pigmentit origjinal të ngjyrave, por dallohet lehtësisht numri i madh i frutave dhe luleve. Mbresa e parë që të ofron kjo tablo është numri i madh i luleve dhe bimësisë.

Në periudhën e Rilindjes, bimët studioheshin kryesisht për vlerat e tyre medicinale; që do të thotë, ato ishin pjesë e *materia medica* (materiale medicinale të gjetura në natyrë). Ndaj, ishin mjekët dhe ata me një përgatitje mjekësore që jepeshin pas studimit të bimëve, kryesisht si një mënyrë për të ringjallur njohuritë mjekësore të të parëve të lashtë. Interesi për studimin e bimëve u rrit si rezultat i ri-zbulimit të veprave klasike mbi bimët, si dhe ndikimin klasik të humanistëve në shkencën e mjekësisë. Por, Botticelli e çoi edhe më tej interesin ndaj luleve duke pikturuar rreth dyqind lloje të ndryshme me saktësinë dhe detajimin më të madh. Ato shtjellohen me imtësi teksta dalin nga goja e Kloris, në fustanin, në duart, mbi flokët, rreth qafës së Florës, por edhe poshtë këmbëve të figurave, në bar edhe pemë. Deri më sot janë identifikuar 138 lloje bimësh në këtë tablo, pjesa tjetër ende nuk janë zbuluar për emrin e tyre.

Duke shqyrtuar zbulimet me lule që shpalosen në plan të parë, një botanist mund të dallojë shumë lehtë dhe t'i emërojë një e nga një bimët dhe lulet e ndryshme që gjenden në të, edhe pse secila lule mund të ketë pasur si qëllim në vetvete të përcjellë një kuptim të veçantë simbolik, magjik ose astrologjik.

Stili i Botticelli-t ishte dekorativ dhe konturor, por mbi të gjitha ishte origjinal. Figurat që pikturonte ishin me linja të qarta por dukeshin sikur pluskonin pa peshë, me masa të buta dhe aspak muskolor, por të fortë.

Figurat në këtë tablo nuk kanë perspektivë lineare, por perspektivë atmosferike. Venusi është më larg nga figurat e tjera, megjithatë nuk duket më e vogël sesa ato, siç ndodh në perspektivën lineare, por Botticelli nuk interesohet aspak për këtë, ai e paraqet atë me një atmosferë të butë, të hirshme, e plot nur, që duket sikur e mposht gravitetin dhe pluskon me butësinë e saj në ajër apo mbi tokën e një realiteti përrallor.

Artisti shpalos më shumë atmosferë sesa saktësi. Të gjitha figurat janë më të gjata e me gjymtyrë më të derdhura sesa duhet. Koka dhe këmbët janë më të vogla në raport me proporcionin e trupit. Gjithashtu, ne nuk arrijmë dot të dallojmë nëse trupat e tri hireve dhe Klois janë të zhveshura apo të mbuluara. Pikërisht këtë ka shpalosur Botticelli, tyli i lehtë mbi to duket si lëkurë e trupave të tyre por njëkohësisht mund të jetë edhe lëkura e tyre që shërben si mbulesë. Për një vend mesdhetar si Italia, lëkura e figurave është më e bardhë dhe më e zbehtë sesa duhet, dhe flokët e femrave në tablo janë të verdha e të kuqe. Ato duken si krijesa të përziera. Një dybotshmëri e tillë, me krijesa gjysmë hyjnore e gjysmë njerëzore, që duken si njerëz por që sfidojnë gravitetin, nuk ishte parë kurrë në art. Dhe padyshim, një koncept i tillë mbi bukurinë do revoluciononte artin në epokat e mëvonshme.

Si një prej piktorëve të preferuar të familjes Medici, Botticelli ndërthuri mitologjinë klasike në këtë vepër, e cila pasqyron atmosferën humaniste të rrethit të kultivuar të familjes së pasur florentinase. Rilindja ishte edhe lindja e humanizmit si filozofi dhe botëkuptim. Por në një shoqëri të krishterë, të ngrije njeriun në pedestalin hyjnor ishte e papranueshme, ndaj falë një qasje tolerante nga etërit e kishës, të cilët e shihnin bukurinë dhe estetikën si vepër të mrekullueshme të duarve të Perëndisë dhe që i shërbenit lavdisë së Tij, mitologjia dhe shumë aspekte pagane e historike gjetën vend në krijimtarinë letrare e artistike të Rilindjes. Ndaj edhe Botticelli përdori alegori dhe shumë simbolika mitologjike.

Lorenzo de Medici, i njohur si Lorenzo i Madhërishmi, pati një ndikim tejet të madh në shkrirjen e simbolikave të paganizmit dhe krishterimit në art e letërsi. Ndaj edhe Botticelli, duke qenë se ishte nën patronazhin e familjes Medici, e dinte se në pikturat e tij, një figurë klasike si Venusi mund të përfaqësohej si burim i dashurisë hyjnore të krahasueshme me Virgjëreshën Mari. Gjatë periudhës mesjetare, një imazh i tillë do të ishte akuzuar si pagan, por brenda rrethit të familjes Medici, misticizmi neoplatonik hapi dyert për krijimin e imazheve alternative të hyjnore.

Dhe ky imazh alternativ vërehet tek portreti i Venusit e cila ngjason si Shën Maria, në pozicionim, por sidomos tek harku në formë aureole që ka pas saj, që krijohet tek pjesa e dukshme e qiellit pas pemëve. Ai hark duket si modeli i një faltore që përdoret gjithmonë për Virgjëreshën Mari ose si tek ikonat fetare. Mbyllni sytë përgjysmë, e shikoni Venusin në këtë tablo, dhe do kuptoni më mirë ngjasimin që ajo ka me Marinë. Dhe barku i saj i fryrë mund të simbolizojë lindjen e jetës, pjellorinë e natyrës, por edhe foshnjën Jezus në barkun e Marisë.

Të gjithë artistët e Rilindjes e morën frymëzimin nga lashtësia. Për Botticelli, antikiteti kishte një vlerë ideale; ajo ishte një përsosmëri e cila

nuk do të arrihej më kurrë, një vend i largët i keqardhjeve dhe i dëshirave. Për këtë arsye ajo nuk mund as të mësohej e as të tregohet; nuk mund të shërbente as si një shembull i prekshëm e as të kishte ndonjë ndikim për të tashmen. Antikiteti nuk ishte më "histori", si baza e farkëtuar e përvojës njerëzore; ajo shtrihej përtej përvojës, përtej thjeshtë identifikimit të vet me monumentet dhe tekstet ekzistuese. Me fjalë të tjera, antikiteti konsiderohej një lloj metafizike, një fe laike, një mit. Por në Evropën e mesjetës u kuptua se tashmë mitet klasike ishin ndërthurrur në besimin e krishterë, se përmes figurës së Krishtit mundësohej që Apollo dhe Orfeu të jetonin sërish, dhe përmes Virgjëreshës Mari mund të shpalosej Diana, Minerva, madje dhe Venusi. Në këtë mënyrë, të paktën për periudhën e Rilindjes, kontradiktat e historisë dhe besimit arritën të shmangeshin, bashkë me detyrimin moral për dallimin midis së vërtetës dhe mitit.

Botticelli, si një artist tejet elegant, pikturoi për të kënaqur më shumë veten sesa të tjerët. *Pranvera*, është një përbërje e qartë alegorike që paraqet një kontrast të mprehtë me strukturën dramatike që kishin zakonisht kompozimet historike. Ai i vuri vetes një synim të ri: të sillte në pikturë idetë e larta letrare dhe filozofike, nëpërmjet ngjyrës së kthjellët, velaturave të holla dhe përsosjes së vizatimit.

Botticelli lindi në Firence në vitin 1445. Vitin e lindjes e kemi të mësuar nga një dokument i babait të tij, Mariano di Vanno Filipepi, i cili i referohet të birin si Sandro me moshë dy vjeçare. Në një dokument tjetër kadastrë i babait të tij, në vitin 1458, thuhet se Sandro është trembëdhjetë vjeç, "sta allegere, ed è malsano" (po rritet dhe është me shëndet të dobët). Shëndeti i tij i dobët duket se e ndoqi artistin gjatë të gjithë jetës, pasi ai i kaloi vitet e fundit i shkëputur nga njerëzit, i varfër dhe i sëmurë.


Botticelli ishte një ndjekës i Savonarolës dhe lëvizjes së tij. Predikimet dhe martirizimi i Savonarolës ndikuan thellësisht në pikëpamjet fetare të

piktorit dhe karakterin e punës së tij të mëvonshme. Pas tablosë *Pranvera* dhe *Lindja e Venusit*, ai nisi të bëhej më i tërhequr, dhe për shkak të përkushtimit personal ndaj Zotit, la pas tematikat alegorike pagane dhe nisi të pikturonte tablo të krishtera. Veprat e tij të fundit përmbanin një besim dhe devotshmëri të thellë në krishterim. Duke lënë pas kraheve afreske të mrekullueshme në Kapelën Sistine në Vatikan, dhe dy tablotë që i dhanë statusin e mjeshtrit të përhershëm në art, ai u zhduk nga bota artistike, dhe vdiq pa bujë.

Botticelli lindi vetëm shtatë vjet para Leonardo da Vinci, megjithatë në historinë e artit, ai konsiderohet gjithmonë si një piktor i *quattrocento* (viteve 1400) dhe Leonardo da Vinci si një piktor i *cinquecento* (viteve 1500). Ai kishte natyrë të ndjeshme e një fytyrë të trishtuar. Ai mbeti një beqar fanatik. Nuk është e nevojshme të jesh Sigmund Freud për të kuptuar se njerëz të tillë, kur zotërojnë talentin e një imagjinate të pafund, ëndërrojnë gjëra të çuditshme. Dhe kur ajo imagjinatë përkthehet në vepra si *Pranvera*, artisti që e zotëron atë talent shkruan historinë.

Ditët e sotme, shumë pak piktorë janë më të njohur se Sandro Botticelli. Por që nga dita e vdekjes së tij, e derisa ai u ri-zbulua në Angli rreth vitit 1870 nga Dante Gabriel Rossetti, Swinburne, Walter Pater dhe Ruskin, për katër shekuj ai u konsiderua si një artist shumë i vogël, origjinal por "primitiv". Dhe kjo harresë historike ndodhi sigurisht për shkak të hijes që kishin lënë Leonardo, Raphael dhe Michelangelo. Sot tablotë e tij, *Pranvera* dhe *Lindja e Venusit* janë dy veprat më të famshme dhe më të analizuar në botë. Ndaj edhe qëndrojnë të ekspozuara së bashku në galerinë Uffizi në Firence.

Kur gjendesh përballë tyre ndien një yshtje të dybotshme, e cila të fton të bëhesh pjesë e skenës dhe të shtyn ta shkrish vështrimin në një lloj bukurie të re, e të përballesh me një fytyrë të panjohur të artit, e cila të josh e të tundon të dëshirosh që të bëhesh edhe ti pjesë e asaj skene.



STEFAN
HERTMANS

ROMAN



LUFTË
DHE
TERPENTINË

 OMBRA GVG
ditë 1999-2022